

JOSIF KOLE

PJESËZAT SI KATEGORI LEKSIKO-SEMANTIKE NË SHQIPEN E SOTME

Pjesëzat, si një lloj i veçantë i fjalëve shërbyese, në gjuhësinë botërore, kanë filluar të dallohen vonë. Më parë ato janë trajtuar në gramatikat ruse¹; së këtejmi ato zunë vend gjithnjë më shumë edhe në gramatikat e gjuhëve të tjera.

Edhe tek ne për pjesëzat ka filluar të flitet tani vonë. Trajtimi i pjesëzave të shqipes qoftë si kategori leksiko-semantike, qoftë si kategori leksiko-gramatikore nuk është ende objekt i ndonjë studimi të veçantë. I vetmi shpjegim pak a shumë i gjerë i pjesëzave si pjesë të ligjëratës është dhënë nga Sh. Demiraj në tekstin e «Morfologjisë së shqipes së sotme» (dispensë). Këto 15 vjetët e fundit pjesëzat janë shpjeguar shumë shkurt në gramatikat e shkollave të ulta. Në të gjitha gramatikat e mëparshme, që nga ajo e S. Frashërit (1886) e deri tek ajo e K. Cipos (1949) koncepti *pjesëz* nuk ekziston dhe pjesëzat ose nuk zihen fare në gojë ose konsiderohen dhe trajtohen si pjesë të tjera të ligjëratës»².

Mungesa deri në kohët e fundit e një koncepti të qartë për pjesëzat, mungesa e studimeve të ndryshme për to, mënyra e trajtimit të tyre në gramatikat e mëparshme, të gjitha këto së bashku, kanë ndikuar edhe në mënyrën e pasqyrimin të pjesëzave në fjalorët e ndryshëm të shqipes.

1) Para së gjithash kemi parasysh përcaktimin dhe shpjegimin që u bëjnë pjesëzave akademiku V.V. Vinogradov në «Russkij jazyk», Moskë 1947, dhe E.M. Gallkine — Fjedoruk në «Sovremjennyj russkij jazyk», Moskë 1952.

2) Kështu S. Frashëri pjesëzat *mbase*, *vallë*, *ndofta* i trajton si «mifolje mënyre», pjesëzat *po*, *posi*, *e*, si «mifolje vërtetore», pjesëzat *jo*, *nuk*, *mos*, *s*, *se mos*, si «mifolje prapsetore», pjesëzën *a* e quan thjesht «mifolje», ndërsa pjesëzën që «parje» (*Shkronjëto e gjuhës shqipe*, Bukuresht 1886, f. 130-132). Në *Gramatikën shqyp* (Shkodër, 1909) A.M. Xanoni bën fjalë kalimthi për «grimcat» *a*, *po*, *dot* pa treguar se ç'pjesë të ligjëratës përbëjnë këto *grimca*.

I.D. Sheperi thekson se «në ndajfoljet rreshtojnë» edhe disa fjalëza, të shumtat e të cilavet shërbejnë për të bërë lokucione me fjalët që plotësojnë. Këto më të shumtat ndajfolje mënyre janë fjalëza: 1) *pohimi*: *po*, *posi*, 2) *mohimi*: *jo*, *nuk*, *s*, *mos*, 3) *pyetjeje ose dyshimi*: *a*, *mos*, *vallë*, 4) *dëftimi*: *ja*, (geg. *qe*), *na*, *tek*, *po*, 5) *vijimi*: *po*, 6) *betimi*: *shyqyr*, *pasha*, 7) *lutjeje*: *makar* (geg. *kish*), 8) *mundësie*: *dot*, 9) *sasie*: *para*, 10) *vendit*: *mu(n)*, 11) *përcjellore*: *duke* (*tue*), 12) *paskajore*: *me* (Fjalëza «*me*» e paskajores, është parafjala *me*, e përdorur posaçërisht si fjalëz paskajore), (*Gramatika dhe sintaksa e gjuhës shqipe*, Vlorë 1927, f. 121). Me sa shihet klasifikimi i Sheperit është shumë më i plotë dhe i thellë se çdo klasifikim i mëparshëm. Megjithatë do thënë se dhe tek ky autor koncepti *pjesëz* mungon. Edhe Sheperi nuk i dallon pjesëzat si pjesë më vete të ligjëratës. Myderrizi fut pjesëzat *po*, *posi* në ndajfoljet e pohimit, *jo*, *mos*, *nuk* në ndajfoljet e mohimit, *vallë*, *a* në ndajfoljet e pyetjes, *po*-në e vazhdimësisë, *mu(mun)*, në ndajfoljet e kufizimit, ndërsa *ndoshta* e *ndro* i quan ndajfolje dyshimi (*Gramatika e Re e shqipes*, f. 274). A. Xhuvani nuk i trajton pjesëzat në gramatikat e tij, as edhe në pjesë

Edhe në këta fjalorë, pjesëzat janë pasqyruar pak³. Të shumtën ato janë dhënë si ndajfolje, herë të tjera nuk shoqërohen fare me shënime gramatikore ose vlerësohen thjesht si *grimca*, si *fjalëza* ose si *pjesë të ngurosura të pandryshueshme të ligjëratës*. Kjo traditë është ndjekur edhe në «Fjalorin e gjuhës shqipe» (1954), tek i cili pa ndalemi më shumë.

1) Në vartësi nga vlerësimi i përgjithshëm teorik gjuhësor që u është bërë pjesëzave, ato janë pasqyruar në këtë fjalor jo si pjesëza, por si pjesë të tjera të ligjëratës. Kështu janë dhënë:

a) *si ndajfolje*: pjesëzat përcaktuese *pikërisht, tamam, mu(mun), bash, krejt*; pjesëzat veçuese a kufizuese *vetëm, veç, sidomos veçanërisht*, pjesëzat e përafërisë *nja, afro, rreth, gati, pothuaj, pothuajse, thujajse, mend(ment, mënt), desh (dish)*; pjesëzën përforcuese *dot*; pjesëzat mohuese *nuk, s, mos, jo*; pjesëzat pohuese *po, posi*.

b) *si lidhëza*: pjesëzat përforcuese *bile, madje*; pjesëza e përafërisë *sikur*: pjesëza aspektive *sapo*; pjesëza emocionale-ekspresive *se* dhe pjesëza ekspresive *pra*.

c) *si pasthirma*: pjesëzat *namëta, na, qe*; pjesëza *ja* jepet si ndajfolje pasthirmë.

d) *si parafjalë*: pjesëzat përforcuese *deri, gjer, që* (p.sh. *që* në të ritë tim).

2) Disa pjesëza nuk shoqërohen fare me shënime gramatikore, nuk u jepet emri që kanë si pjesë të ligjëratës. Në vend të shënimit gramatikor ato marrin pranë, herë shënimin *fjalëz*, herë *fjalë e palakueshme e ngurosor*. Kështu, pjesëza zbutëse *pa* quhet «*fjalëz e fjalisë urdhërore*»; pjesëza përforcuese *që* (p.sh. *që* të katër) quhet *fjalëz për forcim*; pjesëza zbutëse *le* shoqërohet me shënimin «*fjalë që shërben për forcim të urdhërores*». Pjesëzat *me* dhe *për* jepen me shpjegimin *fjalë që formojnë paskajoren*; pjesëza (*s*) *para* quhet «*fjalë e palakueshme*» ndërsa pjesëza *do* «*fjalëz e ngurosor e foljes dua*».

3) Mjaft nga pjesëzat e shqipes, sidomos nga bashkimet e qëndrueshme të fjalëve me vlerën e një pjesëze, nuk pasqyrohen në «Fjalorin e gjuhës shqipe» (1954). Kështu nuk janë dhënë: pjesëza zbutëse *as*; pjesëza e përafërisë *rreth*: pjesëzat emocionale-ekspresive *ama, aspo, de*,

të tjera të ligjëratës. Vetëm në «Buletin e Institutit të shkencave» 1949, nr. 3, f. 64, duke folur për formimin e një sërë ndajfoljeve trajton midis të tjerash dhe *mbase, thujajse, ndoshta*. Së fundi edhe K. Cipo pjesëzat *po, po e po, jo, as, nuk, s, mos, jo që jo*, i trajton si ndajfolje pohimi dhe mohimi ndërsa *thujajse, mbase* si trajta të ngurosura foljore (*Gramatika shqipe*, Tiranë 1949, f. 182).

3) Për të krijuar një ide të përgjithshme mbi pasqyrimin e pjesëzave në leksikografinë tonë kemi vështruar këta fjalorë: K. Kristoforidhi, *Fjalor shqip-greqisht*, Athinë 1904; J. Junk, *Fjaluer i vogël shqyp*, 1895; *Fjaluer i ri i shqyptës*, i shoqërisë Bashkimi, 1908; N. Drizari, *Albanian-English and English-Albanian Dictionary* 1957 (ribotim); P.F. Cordignano, *Dizionario Albanese-Italiano*; A. Leoti, *Dizionario Albanese-Italiano* 1937; S. Mann, *An historical albanian-english*, 1948; T. Lajos, *Alban-Magyarszotar*, 1953; Koçi-Kostallari-Skendi, *Kratkij albansko-russkij slovar*, 1951; *Fjalori i gjuhës shqipe*, 1954. Në këta fjalorë janë dhënë shumë më pak pjesëza, nga ç'janë në të vërtetë në shqipe. Kështu hasen: dy pjesëza tek fjalori i Junktut (*a* dhe *s* prepozitive); një tek fjalori i Bashkimit («*grimca pyetëse a*»); tri tek fjalori i Leottit (*a* si pjesëz e pyetjes së drejtë dhe të zhdrejtë, *sos* si pjesëz pyetëse, *dot* si pjesëz mohuese); pesë tek fjalori i Cordignanos (*a, as, aspo, si* pjesëza pyetëse dhe *jo, nuk* si pjesëza mohuese) tetë tek fjalori i Mannit (*a, ja, qe, na, mos, po, që, s*); katërmbëdhjetë tek fjalori i Kristoforidhit («*grimcat*» *a, as, e, sa, ma* (ma i mirë), *mos* (mo), *mu* (mun), *na, pa*, (mohuese), *pa* (urdhërore), *po, s, të, vallë*); pesëmbëdhjetë tek fjalori i Koçi-Kostallari-Skendit (*a, as, bile, desh, dot, po, ja, jo, po* (pohuese), *le, mos, na, nuk, s*).

ë(hë), se, sec, ç, pa etj., bashkimet e qendrueshme me vlerën e një pjesëze pa le, as që, e po, se mos, ja që (hë), ja pse, ja pra, etj.

4) Si pjesëza janë dhënë vetëm këto:

a («pjesëz pyetëse»); *vallë* («pjesëz që përdoret në fjali pyetëse»); *po* («pjesëz pohore»); *po* («pjesëz që i ngjitet foljes për të treguar vazhdimin e punës dhe aktualitetin e saj»); *sos* («pjesëz pyetëse»).

5) Në Fjalorin e 1954-ës duhej të dalloheshin më mirë kuptimet e mundshme të secilës pjesëze dhe të ndaheshin këto kuptime me shifra arabe.

6) Problemi i paraqitjes së pjesëzave dhe pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës që dalin homonime gjithnjë ka përbërë vështirësi dhe në fjalorë të ndryshëm shqip-shqip e shqip-gjuhë e huaj ka gjetur zgjidhje të ndryshme. (Kështu tek fjalori i Kristoforidhit homonimet tek *po* jepen në një vend të ndara me shifra arabe, ndërsa tek *që*, tek *na*, tek *gati* jepen si fjalë më vete. Tek fjalori i Leottit homonimet *a* (pjesëz) dhe *a* (lidhëz) janë dhënë në një vend, ndërsa tek *po* jepen 6 homonime. Në fjalorin e Mannit homonimet tek *që*, *ja*, *po* jepen gjithnjë në një vend të ndara me shifra arabe. Edhe në fjalorin e shkurtër shqip-rusisht, ku ndiqet një parim i vetëm ka ndonjë shmangje. Në këtë fjalor janë dhënë në një vend të ndara me shifra arabe *as-i* (emër), *as* (lidhëz), *as* (pjesëz).

Në këtë drejtim Fjalori i 1954-ës ka bërë një hap të madh përpara në krahasim me fjalorët e tjerë. Megjithatë paraqitja e pjesëzave homonime midis tyre dhe homonime me pjesët e tjera të ligjëratës jo gjithnjë është bërë si duhet.

Me qenë se pjesëzat në shumicën e tyre janë konsideruar si ndajfolje, si lidhëza, si parafjalë e pasthirma shpesh janë dhënë në një vend me këto ndajfolje, lidhëza, parafjalë e pasthirma si kuptime e përdorime të veçanta, të ndara ose jo me shifra arabe.

Kështu janë dhënë si kuptime të veçanta a përdorime të së njëjtës fjalë: ndajfolja dhe pjesëza *gati*; ndajfolja dhe pjesëza *vetëm*; përmori i pakufishëm *sa*, përmori lidhor *sa*, lidhëzat (krahasore, rrjedhore, kohore, lejore) *sa*, pjesëza aspektive *sa*; lidhëza dhe pjesëza *sapo*; lidhëzat (ftillonjëse, krahasore, shkajkore) *se*, përmori pyetës *se* dhe pjesëza emocionale-ekspresive *se*. Ndonjëherë kuptimet e së njëjtës pjesëze në këtë fjalor janë dhënë si homonime. Kështu janë dhënë p.sh. dy kuptime të pjesëzës pohuese *po* (I «*Po* ndf. me kuptimin gjithë krejt; *po ashtu*, *po ajo gjë* etj.» II «*Po* pjesëz pohore: *a do të vish?*— *Po...*; *antonim jo*». Por do thënë këtu se ky antonim *jo* i pjesëzës pohuese *po* është dhënë më parë në fjalor si ndajfolje mohuese, megjithëse dihet që antonimet nuk mund të jenë pjesë të ndryshme të ligjëratës).

Mendojmë se në rastet e mësipërme kemi të bëjmë jo aq me dy homonime se sa me dy kuptime që duhet të jepen të ndara me shifra arabe në artikullin e së njëjtës pjesëz pohuese *po*.

Nga sa u tha më sipër, kuptohet se studimi i pjesëzave si në plan gramatikor ashtu dhe në plan leksikor është i nevojshëm dhe me interes. Ka një sërë çështjesh, të cilat mund të shihen në punime të veçanta. Qëllimi i këtij punimi është të përcaktojë pjesëzat si një lloj i veçantë i fjalëve shërbyese dhe të bëjë një klasifikim të tyre.

Fjalët shërbyese a të pamëvetësishme, ku veç pjesëzave hyjnë edhe lidhëzat, parafjalët, foljet ndihmëse, foljet këpujë, artikujt ose nyjet, zënë vend të veçantë në përbërjen e fjalorit të një gjuhe. Ky vend përcaktohet në radhë të parë nga pamëvetësia e tyre, nga pamundësia për

të qëndruar pa fjalët shënuese me të cilat shoqërohen: a) për të shprehur marrëdhënjet gramatikore që janë të nevojshme për ndërtimin e fjalisë dhe të frazës, b) për të sjellë nuanca kuptimore dhe modale në kuptimin e fjalëve, të togfjalëshave dhe të fjalive të tëra, c) për të treguar ndonjë karakteristikë gramatikore.

Fjalët shërbyese si fjalë që nuk qëndrojnë dot më vete nuk mund të jenë gjymtyrë të fjalisë. Edhe aftësinë e të emërtuarit të sendeve, të fenomeneve, të proceseve e të tipareve ato nuk e kanë.

Fjalët shërbyese nuk shprehin nocion (cilat veti të përgjithshme e themelore dhe të cilit send, fenomen etj. shpreh një lidhëz, një para-fjalë, një pjesëz a çdo fjalë tjetër shërbyese?). Mendimi se fjalët shërbyese shprehin nocion «një nocion i veçantë ky i marrëdhënjeve»⁴ për ne është i papranueshëm. Aftësia e fjalëve për të shprehur idenë e marrëdhënjeve (të hapësirës, të kohës, të qëllimit, të bashkimit, të përforcimit, të përjashtimit, të përcaktimit etj.) përbën kuptimin leksikor të tyre që nuk është një me nocionin, qoftë ky dhe «i veçantë». Ky kuptim leksikor i fjalëve shërbyese bëhet i qartë a zbulohet nga konteksti, nga kuptimi i fjalëve të mvetësishme, me të cilat shoqërohen, është pra një kuptim leksikor i pamëvetësishëm.

Është mjaft i përhapur mendimi, sipas të cilit fjalët shërbyese nuk kanë kuptim leksikor ose vetë kuptimi leksikor në to është gramatikor⁵. Ku qëndron atëhere thelbi i ndryshimit midis leksikut dhe strukturës gramatikore?! Përderisa fjalët shërbyese janë njësi leksikore të veçanta ato pa tjetër kanë edhe kuptim leksikor. Do theksuar këtu që kuptimet e marrëdhënjeve mund të jenë jo vetëm gramatikore, por dhe leksikore. «Kështu ato janë leksikore, në qoftë se tregojnë themeloren a qendroren në semantikën e fjalës, në qoftë se shprehen me fjalë të veçanta. Që të jetë gramatikor kuptimi i marrëdhënjes, duhet të jetë vetëm plotësues pranë kuptimit themelor a qendror... Në qoftë se para-fjala në është fjalë e veçantë dhe jo parashtesë, atëhere kuptimet e hapësirës, të kohës dhe marrëdhënjet e tjera të shprehura në të, janë themeloret e kuptimit të saj, i përkasin asaj si fjalë e dhënë konkrete dhe e dallojnë nga para-fjalët e tjera...»⁶

Kjo vërejtje e dhënë për para-fjalët vlen për të gjitha fjalët shërbyese. Ato si njësi leksikore kanë kuptim leksikor, megjithëse jo të mvetësishëm. Ky kuptim leksikor nuk «thithet» e nuk «tretet» nga kuptimi gramatikor. Të mohosh kuptimin leksikor të fjalëve shërbyese, do të thotë të mohosh vetë ekzistencën e tyre si njësi leksikore më vete.

Mungesa e kuptimit leksikor të mvetësishëm, mungesa e funksionit emërtues, paaftësia për të qenë gjymtyrë më vete të fjalisë janë tipare të qenësishme që i bashkojnë pjesëzat me fjalët e tjera shërbyese. Vetëm në kushte të caktuara dhe të njohura, në bashkëbisedimet, pjesëzat, në dallim nga fjalët e tjera shërbyese mund të përdoren si fjalë olofrastike, si përgjigje të një pyetjeje të tërë a të një urdhëri, përbëjnë në këtë mënyrë ndërtime mungesore me vlerën e një fjalie. P.sh.

— «Prapë misrin do të mbajmë ne qerrratët? — Po.» (T. Laço,

4) Shih për këtë A.A. Reformatskij, *Vvedenje v jazykoznanije*, Moskë 1960, f. 49.

5) Sipas V.V. Vinogradovit «Kuptimi leksikor i këtyre fjalëve përputhet me funksionin e tyre gramatikor» («Russkij jazyk», Moskë 1947, f. 663). Të njëjtin qëndrim mban dhe A.A. Reformatskij. «Kuptimi i tyre leksikor -thotë ay- përputhet me kuptimin gramatikor. Do të thoshim që funksioni gramatikor thith a përpun në fjalët shërbyese natyrën e tyre leksikore» (vepër e cituar më sipër, f. 239).

6) A.I. Smirnicki në «Trudy instituta jazykoznanija» AN, BRSS, IV, 1954, f. 75-76.

«Njerëz të dherave të lëruara», Drita, 6.10.1968. /«— Po Gimi ç'thotë, a ju shkruan? — Jo, o i harruari! Një letër në muajt!» (Po ay, po aty).

Por pjesëzat kanë dhe një sërë vetish që i dallojnë ato nga fjalët e tjera shërbyese. Për të përcaktuar më mirë vendin që zënë pjesëzat midis fjalëve të tjera të një gjuhe, e në radhë të parë midis fjalëve shërbyese, për të zbuluar më mirë afëritë dhe ndryshimet që kanë ato nga fjalët e tjera të pamëvetësishme duhet t'i përmbahemi një nocioni të caktuar mbi pjesëzat.

Megjithëse pjesëzat si njësi leksikore janë të pakta, bile të numërueshme, ndarja e tyre nga fjalët e tjera shërbyese, nga ndajfoljet dhe nga fjalët modale nuk është e lehtë. Është e vështirë të japësh për to një përcaktim që të plotësonte të gjitha kërkesat e mundshme. Sh. Demiraj, duke miratuar mendimet e disa gjuhëtarëve sovjetikë e sidomos të akademikut V.V. Vinogradov, jep këtë përkufizim për pjesëzat: «Ato mund të karakterizohen si fjalëza që shërbejnë për të shprehur nuanca kuptimore suplementare të një fjale të veçantë, të një grupi fjalësh a të një fjalie të tërë, si dhe për të sajuar disa forma gramatikore. Sipas disave, pjesëzat mund të shërbejnë edhe për të formuar fjalë a lokucione të reja fjalësh»⁷.

E meta e këtij përkufizimi, i pari përkufizim për pjesëzat në shqipe, është se nuk jepen të gjitha veçoritë tipike të pjesëzave. Lihet mënjanë të shprehurit nga ana e tyre e modalitetit, e emocionit të folësit dhe e ekspresivitetit. Gjatë trajtimit që u bën pjesëzave. Sh. Demiraj nuk dallon qartë dhe nuk përcakton pjesëzat modale dhe ekspresive si tipe të mëdha të veçanta të pjesëzave të shqipes. Vështrohen vetëm disa nga llojet që përbëjnë pjesëzat modale dhe pjesëzat emocionale ekspresive (pjesëzat e pohimit *po, po se po, si urdhëron*; pjesëzat e mohimit *jo, jo që jo, nuk, s, mos*; pjesëzat e dyshimit *ndofta, mbase, vallë* dhe pjesëzat *po, le, sec, se, ç, sa*). Numri i pjesëzave modale dhe emocionale-ekspresive në gjuhën shqipe është mjaft i madh. Përdorimi i tyre në gjuhën e folur, sidomos në bashkëbisedimet, është mjaft i gjerë. Roli i këtyre pjesëzave në shprehjen e modalitetit, në shfaqjen e emocionit të folësit, në rritjen e fuqisë shprehëse të ligjërit është i madh dhe do pasur parasysh në dhënjen e çdo përkufizimi për pjesëzat. Me fjalë të tjera, ne mendojmë që *pjesëzat mund të karakterizohen si një lloj i veçantë i fjalëve shërbyese që shërbejnë për t'u dhënë nuanca kuptimore plotësuese fjalëve, togfjalëshave dhe fjaltive të tëra, ose për të shprehur qëndrimin subjektiv të folësit a të autorit ndaj asaj që thuhet e shkruhet, si dhe për të shprehur emocionin e për të rritur ekspresivitetin. Një grup të veçantë përbëjnë pjesëzat që plotësojnë funksione fjalëformuese dhe trajtëformuese e që mund të emërtohen pjesëza gramatikore.*

Në sajë të këtyre veçorive kryesore, pjesëzat dallohen mirë nga të gjitha fjalët e tjera shërbyese që përdoren vetëm për të vënë në marrëdhënie midis tyre fjalët dhe fjalitë, për të treguar ndonjë karakteristikë gramatikore të fjalëve.

Vendi që zënë pjesëzat në fjalorin e një gjuhe qëndron midis lidhëzave nga njëra anë dhe fjalëve modale e ndajfoljeve nga ana tjetër.

Ndër të gjitha fjalët shërbyese, më të afërta me pjesëzat janë lidhëzat. Në gjuhën shqipe, si dhe në gjuhë të tjera, është tipike qenja e pjesë-

⁷ Sh. Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, pjesa II (dispensë), Tiranë 1963, f. 287.

zave përforcuese homonime me lidhëzat bashkërenditëse shtonjësë *e, dhe, edhe* p.sh.

«*Edhe* dordolec le të shkante në dasmë!» (Dh. Sh. «Kënga...» f. 210) / «*Ajo dhe* ma përmendi bile, kur po dilnim nga shtëpia» (Sh. M. «Para...» f. 306).

Nga sa mund të duket dhe në këta dy shembuj kuptimi përforcues kombinohet me kuptimin lidhëzor. Vetë përforcimi i pjesëzavet i afron këto me lidhëzat.

Në mjaft raste ndodh shndërrimi funksional i lidhëzave në pjesëza p.sh.

«Krahneri i tij asht një copë granit që u shkëput nga mali dhe u vendos mbi dy kambë të drejta e të forta si landa e pyllit. *Dhe* lëvizet copa e pyllit pa bëzajtë. *E* përpara depos së misrit bjerr cilësinë karakteristike të vetëm dhe bahet frigacak». (Migjeni «Luli i vocër» f. 61). / «*Se ç'ish* e saja, gjyshja e kish këtë: të vinte në gjumë, kur desh, me një të hapur gojë». (M.K. «Netë shqiptare», f. 65) / «*Kur* ja, ai erdhi papritur» (F. Gj. «Përmbysja»).

Me gjithë këtë lidhje të ngushtë të pjesëzave me lidhëzat, ato ndryshojnë midis tyre, ndryshon funksioni i pjesëzave nga ai i lidhëzave, që shërbejnë për të lidhur midis tyre fjalët dhe fjalitë. Ndër pjesëzat, ndryshe nga lidhëzat, ka nga ato që shërbejnë për të sajuar forma gramatikore të fjalëve të cilave u referohen. Pjesëzat si të gjitha fjalët shërbyese nuk përbëjnë ndonjë bazë për formimin e fjalëve të reja. Por megjithatë disa prej pjesëzave, duke plotësuar funksione fjalëformuese, të ngjashme me ato të parashtesave dhe prapashtesave, ndihmojnë që nga fjalë të tjera të formohen fjalë të reja. Këtë veti të pjesëzave lidhëzat nuk e kanë, ndërsa në fjalët e tjera shërbyese një gjë e tillë vihet re shumë rrallë.

Pjesëzat, sidomos pjesëzat modale, kanë afëri të madhe me ndajfoljet dhe fjalët modale. Afërinë me ndajfoljet e tregojnë ndër të tjera:

1. Prania e një sërë pjesëzave si *pikërisht, ndoshta, tamam, vetëm, gati* etj., të cilat kanë dalë si rezultat i zbehjes semantike të ndajfoljeve përkatëse, i humbjes së kuptimit leksikor të pavarur nga ana e tyre.

2. Shfaqja e së njëjtës fjalë herë si ndajfolje e herë si pjesëz, në vartësi nga konteksti, nga lidhjet sintaktike me fjalët e tjera, nga intonacioni, nga kushtet e ligjërimit etj.

Tek afëria e pjesëzave me ndajfoljet e ka burimin edhe trajtimi si ndajfolje, që u është bërë aty-këtu dhe vazhdon t'u bëhet mjaft pjesëzave.

Megjithatë ndajfoljet si tip fjalësh dallohen mirë nga pjesëzat. Ato bëjnë pjesë në fjalët shënuese e të mëvetësishme dhe si të tilla kanë aftësinë e të emërtuarit (emërtojnë ndonjë rrethanë a cilësi të veprimit ose të gjendjes), kanë kuptim leksikor të pavarur, shprehin nocion dhe mund të përbëjnë gjymtyrë të veçanta në fjali. Të gjitha këto veçori pjesëzat — siç u tha — nuk i kanë⁸.

Sa për ilustrim të këtyre që u thanë mund të sillen këtu disa shembuj ku e njëjta fjalë haset një herë si ndajfolje e pastaj si pjesëz:

Si ndajfolje: «E shoqja u ngrit të na presë. Nuk dinte asgjë. Dy fëmijë katër-pesë vjeç na u vërsulën: — Ku është babi? (S.A. «Lufta par-

8) Edhe më poshtë në përcaktimin si pjesëza të mjaft fjalëve, të trajtuara deri vonë si ndajfolje, do të bazohemi në këto ndryshime themelore midis pjesëzave dhe ndajfoljeve.

tizane», f. 67)/ «Shumë vonë u ktheve! Vetëm ishe? — Vetëm» (T. Laço, «Njerëz të dherave të lëruara», Drita, 6.10.1968).

Si pjesëz: «Ku u bëre ti të matesh me mua?!» (Mësuesi, 24.3.1967).
/«Vetëm familjen të takoj? Nuk ke njeri tjetër?» (S.A. «Tregime nga Morava», f. 86).

Së fundi, edhe afëria e fjalëve modale me pjesëzat është e madhe e mund të vihet re nga këto ngjashmëri:

1. — Pranë pjesëzave modale ekzistojnë fjalët modale. Që të dyja palët përdoren krahas mjeteve të tjera gjuhësore (mënyrave, kohëve e formave foljore, intonacionit) për të shprehur modalitetin, qëndrimin subjektiv të folësit për atë që është thënë. Kufiri që ndan fjalët modale nga pjesëzat modale është shumë i paqëndrueshëm e nuk dallohet qartë.

2. — Fjalët modale sikurse pjesëzat nuk mund të përbëjnë gjymtyrë më vete të fjalisë, por në dialoget ato mund të jenë ekuivalente me një fjali të tërë. Në këto raste, ato, duke ruajtur lidhjen me atë që është thënë më parë, formojnë përgjigje të barazvlershme me thënje të tërë modale. Në përdorime të tilla pjesëzat modale dhe fjalët modale qëndrojnë më afër se kurdoherë⁹.

Por midis fjalëve modale dhe pjesëzave ka dhe ndryshime.

1. — Fjalët modale, siç u tha, janë më të mëvetëshme se pjesëzat. Ato, në dallim nga pjesëzat, kanë kuptim leksikor të pavarur, megjithëse mjaft të zbehur (krahaso *natyrisht, sigurisht, duhet, pa dyshim* etj. me *nuk, ja, se, mu* etj.)

2. — Pjesëzat mund të shprehin qëndrimin subjektiv të folësit ndaj asaj që është thënë, mund të sjellin në fjali nuanca të ndryshme kuptimore, emocionale e ekspresive (dëftim, saktësi, përafëri, kënaqësi, përbuzje, ironi etj.). *Fjalët modale shprehin vetëm qëndrimin subjektiv të folësit ndaj ligjërimit (pohim, mohim, mundësi, siguri, domosdoshmëri etj.*¹⁰

3. — Pjesëzat përbëjnë pjesë më vete të ligjëratis. Fjalët modale nuk mund të grupohen në një pjesë të vetme të ligjëratis, qëndrojnë jashtë lidhjeve vetëm me një pjesë të caktuar leksiko-gramatikore, ato mund të jenë ndajfolje, folje, emra me dha pa parafjalë etj. (p.sh. *natyrisht, medoemos, patjetër, lipeset, pa dyshim* etj.)

4. — Fjalët modale shprehin a theksojnë modalitetin e të gjithë fjalisë në tërësi, të shumtën në rolin e fjalëve të ndërmjetme. Ndër pjesëzat ka nga ato që theksojnë jo vetëm kuptimin e fjalisë, por dhe atë të një togfjalëshi a fjale të vetme¹¹. Fjalët modale vendosen sikur të ishin në plan tjetër gramatikor nga plani i elementëve të tjerë të fjalisë. Duke mos hyrë në lidhje gramatikore me fjalë të tjera të fjalisë, ato nuk përbëjnë gjymtyrë të fjalisë, nuk plotësojnë ndonjë gjymtyrë tjetër të fjalisë. Mund të luajnë rolin e fjalëve të ndërmjetme, duke theksuar modalitetin e fjalisë a kallëzuesit.

Afëria e madhe e pjesëzave me fjalët e tjera shërbyese si edhe me ndajfoljet është pasqyruar edhe në përdorimin e termit pjesëz

9) Shih për rusishten edhe E.M. Gallkina-Fjedoruk, *Sovremjennyj russkij jazyk*, Botim i Univ. të Moskës, 1952, 414.

10) Shih për këtë E.M. Gallkina-Fjedoruk, po aty, f. 405-411, si dhe *Sovremjennyj russkij jazyk* II, Botim i Univ. të Moskës, 1964, f. 223-229; V. Vinogradov, *O kategorii modalnosti v russkom jazykje*, BRSS, Moskë-Leningrad, 1950, f. 49.

11) Shih për rusisht E.M. Gallkina-Fjedoruk, *Sovremjennyj russkij jazyk*, Moskë, 1952, f. 414.

për dy koncepte¹². Së pari termi *pjesëz* është përdorur si emërtim i përbashkët për të gjitha fjalët shërbyese, bile shpesh edhe për ndajfoljet e për çdo pjesë të pandryshueshme të ligjëratës. Vonë pjesëzat u dalluan si një tip i veçantë i fjalëve shërbyese dhe termi *pjesëz* vazhdon të përdoret për të emërtuar edhe fjalët shërbyese, ndajfoljet etj., edhe pjesëzat e vërteta.

Më drejt është që termi *pjesëz*- (sado i pasaktë) të përdoret vetëm për pjesëzat e vërteta. Nuk ka ndonjë arsye që të na detyronte që me këtë emër të quanim në shqipe të gjitha fjalët shërbyese, çdo fjalëz të palakueshme, bile edhe ndajfoljet. Pjesëzat, megjithë afërinë e madhe që kanë me fjalët e tjera shërbyese, me ndajfoljet e fjalët modale, si e pamë, dallohen mirë prej tyre. Ky dallim duhet të pasqyrohet edhe në emërtimin e këtyre fjalëve.

A. — Klasifikimi i pjesëzave të shqipes së sotme sipas kuptimit.

Pjesëzat mund të klasifikohen duke u nisur nga shumë anë a veçori të tyre. Për leksikologjinë dhe leksikografinë është me rëndësi klasifikimi i pjesëzave sipas kuptimit të tyre si dhe sipas origjinës a prejardhjes së tyre. Në këtë punim, problemi i prejardhjes së pjesëzave, i formimit dhe i mënyrave a rrugëve të formimit të grupeve të reja të pjesëzave nga fjalët dhe pjesëzat e tjera do të preket në vija të përgjithshme.

Pjesëzat janë një kategori relativisht e re e fjalëve. Ato kanë dalë:

1) *Nga fjalët shënuese a të mvetësishme, me zbehjen e madhe të kuptimit leksikor të këtyre fjalëve, me ndryshimin dhe humbjen e funksionit të tyre sintaktik të mëparshëm.* Këto pjesëza shpesh i kanë humbur lidhjet me fjalët prej të cilave kanë dalë e për rrjedhim është vështirë t'i rivendosësh këto lidhje pa një analizë speciale etimologjike. Bile, ka mjaft raste në të cilat edhe kjo analizë nuk mund të ndihmojë. Herë të tjera këto pjesëza i ruajnë të gjalla lidhjet me fjalët prej të cilave kanë dalë, e atëhere mund të bëhet i lehtë një klasifikim i pjesëzave sipas prejardhjes. Kështu dallojmë:

a) pjesëza me origjinë ndajfoljore (*mu, pikërisht, taman, afro, po-thuajse, pothuaj, thuajse, gati, krejt, ndofta, ndoshta* etj.).

12) V.V. Vinogradov vë në dukje se *pjesëz* në kuptimin e përgjithshëm do të thotë fjalëz e ligjëratës, fjalëz shërbyese, fjalëz lidhëz. *Russkij jazyk*, Moskë, 1947, f. 663. «Termi *pjesëz* — shkruan Gallkina-Fjedoruk — ka kuptim të gjerë dhe të ngushtë. Në vështrimin e gjerë me këtë term nënkuptohen të gjitha fjalët shërbyese, ndërsa në të ngushtin nënkuptohen pjesëzat e vërteta» *Sovrenennyj russkij jazyk (morfologjia)*, Moskë 1952, f. 412. Zh. Maruzo gjithashtu me emrin *pjesëz* quan vec pjesëzave të vërteta dhe parafjalët dhe lidhëzat *Fjalor i termave gjuhësore* (botim rusisht), Moskë, 1960, f. 334. Po në *Fjalorin e termave gjuhësore* të Maruzoit, në shënimin e vet redaksia thekson se në gramatikën ruse pjesëza quhen të gjitha fjalët shërbyese. Në fjalorin e vogël dyvëllimsh të gjermanishtes (*Lexikon A-Z in zwei Bänden*, Leipzig 1957, f. 319) shënohet se me emrin *pjesëz* nënkuptohet çdo fjalëz e pandryshueshme e ligjëratës, parafjalët dhe lidhëzat, ndërsa në «Grosse Brockhaus» (Vëllimi XIV, f. 206) termi *pjesëz* shpjegohet si emërtim i përbashkët për pjesët e palakueshme të ligjëratës, për parafjalët, lidhëzat dhe ndajfoljet. Në gjuhën shqipe termin *pjesëz* sëpari e hasim në fjalorin e Bashkimit si një kalk i fjalës *particula*. Ky term, siç u tha, është përdorur qoftë në gramatikat tona, qoftë në fjalorë me kuptimin e gjerë të tij. Deri dhe në Fjalorin e 1954-ës për fjalën *pjesëz* jepet ky shpjegim: «pjesë e palakueshme e ligjëratës, fjalëz që shërben si fjalëz lidhëz, si dhe për ta bërë më të qartë kuptimin e një fjalie, si p.sh. pa na thuar një përrallë» (f. 415).

b) pjesëzat me origjinë foljore *do* dhe *le*

c) pjesëzat me origjinë përemërore (pjesëza mohuese *s*¹³, dhe pjesëza vetvetore *u*).

d) në pjesëzat e formuara me këtë rrugë nga përemrat e ndajfoljet pyetëse, mund të rendim edhe pjesëzat thirrmore e esklamative (*ç, sa, si, qysh, ku, kur, pse* etj.).

2. — *Nga fjalët shërbyese me ndryshimin e funksionit të tyre të mëparshëm.* Fjalët shërbyese nuk shërbejnë më për të zbuluar marrëdhënjet midis fjalëve dhe fjalive po për të sjellë nuanca kuptimore, modale, emocionale, ekspresive në fjali si dhe për të sajuar forma të ndryshme gramatikore të fjalëve. Në këto pjesëza, që do t'i quajmë pjesëza të shndërrimit funksional, mund të dallojmë:

a. — Pjesëza me origjinë lidhëzore (*të* e lidhore, pjesëzat *zbutëse si, sikur* etj.)

b. — pjesëza me origjinë parafjalore (pjesëza e përafërisë *rreth*, — (si dihet vetë parafjala *rreth* është me origjinë emërore) — pjesëzat trajtëformuese *për, me*, pjesëzat përforcuese *deri, gjer*, pjesëza përcaktuese *që* etj.)

c. — pjesëza me origjinë pasthirrmore (*e, ë, de, a*).

d. — Në pjesëzat e shndërrimit funksional mund të grupojmë me rezervë edhe pjesëzat ekspresive (*a, edhe, sa, që, sikur* etj.), tek të cilat afëria me lidhëzat prej nga vijnë, është mjaft e madhe.

3. — *Nga përngjitja e bashkëngjitja e dy a më shumë fjalëve,* përngjitje që ka ndodhur gjatë kohëve në kushtet e sandhit. Këto pjesëza janë gjithashtu mjaft të reja. Ndër të tjera, në pjesëzat e përngjitur mund të dallojmë *as (a + s), dot (do + të), mos (mo + s), mun (mu + në), pothua, pothuajse*. (*po + thua, po + thuj + se*)¹⁴, *nja (një + a), posi (po + si), aspo (as + po)* etj.

4. Së fundi, do thënë që mjaft pjesëza dalin në formën e lokucioneve e bashkimeve të qendrueshme *po si jo, po se po, jo që jo, si urdhëron, as që, pa le, ja pse* etj.

Në këtë punim do të merremi më gjerë me klasifikimin e pjesëzave sipas kuptimit të tyre¹⁵.

Kuptimin e pjesëzave e përbën aftësia që kanë ato për t'u dhënë nuanca të ndryshme kuptimore, modale, emocionale e ekspresive fja-

13) Shih E. Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe*, në «Studime filologjike», nr. 4, 1965, f. 48.

14) Shih edhe E. Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe*, (Për *as dhe dot* në «Buletin i Shkencave shoqërore», nr. 4, 1960, f. 28 dhe nr. 3, 1961, f. 53-54; Për *mos, mu* në «Studime filologjike» nr. 3, 1964, f. 41 dhe 43; për *pothua, pothuajse* në «Studime filologjike», nr. 1, 1965, f. 22-23).

15) Pjesëzat e gjuhës së sotme shqipe janë klasifikuar deri më sot vetëm nga Sh. Demiraj. Për të dalë më të qarta ndryshimet midis klasifikimit që po bëjmë ne në këtë punim dhe klasifikimit të Sh. Demirajt, klasifikimin e këtij të fundit po e japim të plotë. (Grupet, nëngrupet dhe emërtimet e tyre). Sipas funksionit Sh. Demiraj dallon këto grupe të mëdha pjesëzash: I. Pjesëza që shprehin nuanca kuptimore suplementare të një fjale, të një togfjalëshi a të një fjalie (I — *dëftore: ja, qe, nji*; 2 — *përcaktonjëse: mu, që pikërisht*; 3 — *veçonjëse: vetëm, veç, sidomos* etj.; 4 — *zbutëse: po, as, le, para, pothuaj, gati, afro, nja, sinja, etj.*; 5 — pjesëza që shprehin habitë dhe kënaqësinë e folësit: *ç, seç, se*, dhe së fundi pjesëzat *po, sa, sapo, në, deri, (gjer)*. II. Pjesëzat: 1 — të pohimit: *po, posepo, po që po, si urdhëron* etj. 2 — të mohimit: *jo, jo që jo, nuk, s, mos*; 3 — të dyshimit, *ndofta, mbase, vallë, dot*); III. Pjesëzat fjalëformonjëse: (*u, do, të, me, për, duke (tue)*); IV Pjesëzat fjalëformonjëse: *di, do, akë, deri, gjer*; (*Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe* (dispensë) II, Tiranë, 1963, f. 287-293).

lëve, togfjalëshave dhe fjalive të cilave u referohen. Në bazë të këtij kuptimi, d.m.th. në bazë të këtyre nuancave kuptimore, modale etj. pjesëzat mund t'i klasifikojmë¹⁶:

I. Pjesëzat që shprehin nuanca të përgjithshme kuptimore, jo modale si: dëftim, kufizim e veçim, përafëri, saktësim etj. (*ja, vetëm, afro, pikërisht* etj.).

II. Pjesëza me kuptim modal dhe modal-volitiv: pohim, mohim, dyshim, mundësi, pamundësi, nxitje, lejim, urdhër, dëshirë etj. (*po, jo, nuk, ndofta, le* etj.).

Këto pjesëza, që kanë të bëjnë me qëndrimin e folësit, ndaj asaj që thotë a dëgjon, mund të përmbliidhen edhe nën emërtimin e përbashkët *pjesëza modale*.

III. Pjesëza emocionale-ekspresive që shërbejnë për t'i dhënë ngjyrim emocional të folurit (përkëdhelje, sharje, qortim, ironi, shaka, tallje, kuptim keqësues etj.), për të theksuar ndjenjat e folësit (gëzimin, hidhërimin, brengën, kënaqësinë, mahnitjen, habinë etj.), si dhe për të rritur fuqinë shprehëse (ekspresivitetin) e ligjërit. (*ama, pa le, seç, de, qysh, kur, ku, sa, si, dhe, se* etj.).

IV. Një grup më vete përbëjnë në gjuhën shqipe *pjesëzat gramatikore*. Në grupin e pjesëzave të quajtura me këtë emër hyjnë pjesëzat trajtë formuese dhe fjalëformuese.

Në pjesëzat trajtëformuese grupohen ato që kanë shërbyer ose shërbejnë për të sajuar forma gramatikore të fjalëve. Të tilla janë fjalëzat *u, do, të, me, për, duke*, të përdorura për të sajuar forma gramatikore të foljeve (*u hap, do të hapet, të hapet, me hapë, për të hapur duke hapur*) si dhe pjesëzat ndajfoljore *më, shumë, tepër, mjaft* etj. që shërbejnë për të sajuar shkallët e mbiemrit (*më i mirë, shumë i mirë* etj.). Si pjesëza fjalëformuese, për mendimin tonë, duhen konsideruar ato që dalin si elementë përbërës të fjalëve të përngjitura. Ndër pjesëzat fjalëformuese të shqipes mund të përmendim këto:

Pjesëzën *mos* në fjalë si *çmos, doemos, domosdo, mosnjihërë, moskurrë, mosnjeri* etj.; pjesëza *a* dhe *s* në pjesëzën e përngjitur *as*; pjesëzën *as* në pjesëzën *aspo*; pjesëzat *a* dhe *po* në lidhëzën *apo* (lidhëz «e përfutur në fjali me një verb të pajisur me *po* si» a *po* vjen?»¹⁷); pjesëzat *do* dhe *të* në pjesëzën *dot*; pjesëzën pohuese *po* në pjesëzat *posi* dhe *sapo*; pjesëzën *që* në fjalë si *qëmoti, qëkuri* etj.; pjesëzën *s* në fjalët e preardhura *skamje, sëmundje*. (Këto fjalë janë formuar me anë të prapashtesës *je*) që u është shtuar, si dihet, sintagmave të përngjitura *skam, sëmund* nga *s'kam, s'mund*).

Duke krahasuar pjesëzat fjalëformuese, në fjalë të tilla si të mësipërmet, me parashtesat dhe prapashtesat, në fjalë të preardhura (p.sh. duke krahasuar pejsëzën *mos* në fjalë si *çmos, doemos, domosdo, mosnjihërë, moskurrë, mosnjeri* etj. me parashtesën *mos* në fjalë si *mosmirënjohje, mospërfillje, mossulmim* etj.) mund të nxjerrim si përfundim

16) Grupe analogjike me këto ka dhe në gjuhë të tjera indoevropiane. Do theksuar këtu se vendin që zë pjesëza në këtë klasifikim e përcakton kuptimi dhe përdorimi i saj më i zakonshëm. Kështu, p.sh. çdo pjesëze, në raste të veçanta, mund të përdoret për të përforcuar emocionin e folësit e për të rritur fuqinë shprehëse të ligjërit, por kjo s'do të thotë që pjesëza në fjalë është emocionale-ekspresive. Që të jetë e tillë, pjesëza duhet që gjithnjë të sjellë në ligjërim ngjyrim emocional ose të ketë përherë ngarkesë të theksuar shprehëse (ekspresive).

17) E. Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe*, në «Buletin i shkencave shoqërore», nr. 4, 1960, f. 20.

se, me gjithë afërinë e madhe funksionale të këtyre pjesëzave me parashtesat dhe prapashtesat, ka disa ndryshime të rëndësishme midis tyre. Parashtesat dhe prapashtesat janë *morfema fjalëformuese*, pjesëzat fjalëformuese janë *fjalë*. *Me ndihmën e parashtesave dhe prapashtesave janë formuar e mund të formohen* me vetëdije, sipas modeleve që gjëlojnë në gjuhë fjalë të prejardhura të tipeve të ndryshme (prefiksial, sufiksial, prefiksalo-sufiksial). Në *formimin e fjalëve të reja nga pjesëzat fjalëformuese kemi të bëjmë me tip leksiko-sintaktik të fjalëformimit*. Fjala në këto raste është një formim gjuhësor historik, është rezultat i një përngjitjeje që ka lindur nga përdorimi pranë e pranë e për një kohë të gjatë i dy ose më shumë fjalëve midis të cilave dallohet dhe pjesëza e dikurshme. Në këtë mënyrë *nuk mund të flitet për pjesëza që hasen rregullisht si elemente fjalëformuese të fjalëve, nuk ka pjesëza që të shërbejnë posaçërisht për të formuar fjalë të reja sipas modeleve të caktuara që ka gjuha*. Përkundrazi *kjo apo ajo pjesëz e përdorur në fillim me funksionin e saj të zakonshëm, me kohë u përngjit me fjalë të tjera të fjalisë, duke u shndëruar kështu nga një fjalë dikur më vete në një element fjalë-formues*.

Ka edhe disa pjesëza që, për mendimin tonë, kanë kaluar tashmë në parashtesa. Të tilla janë *mos* dhe *pa* që përdoren për të formuar emra dhe mbiemra të rinj me kuptim mohues nga emrat dhe mbiemrat korespondonjës pa këto parashtesa, jo që u paravihet mbiemrave të panyjshëm, *ish* që vihet para emërtimeve të titujve zyrtarë e nonjëherë edhe para ndonjë fjale tjetër, *porsa* dhe *sapo* që u shtohen pjesoreve të adjektivizuara për të formuar mbiemra të rinj. Shembuj:

«Një çerek shekulli po mbushet nga ajo ditë kur rinia jonë e *sapodalë* nga lufta, hidhte kazmat e para për hapjen e rrugës Kukës-Peshkopi» (Zëri i Popullit, 22.6.1969/ «... e ëma shihte si bohçellëku i saj i *porsalarë* ndehej si leckë në karrige» (Sporti Popullor, 24.4.1966)/ «Fshati i ndërtuar në *ish themelet* e kasolleve, ... ka marrë tani tiparet e një qyteti të vogël» (Zëri i Popullit, 2.7.1968)/ «Vetëm një organizim i shëndoshë e jo i çalë, konkret e jo i përgjithshëm, i udhëhequr e *jospontan*, ... përbën garancinë për suksesin e këtij aksioni të madh politik e ideologjik» (Zëri i Popullit, 14.4.1968).

Për pjesëzat trajtë formuese dhe fjalëformuese, për afërinë dhe ndryshimin e tyre nga morfemat, mund të flitet më gjatë në një punim të veçantë. Më poshtë ne do të merremi me tre grupet e tjera të pjesëzave, më klasifikimin a ndarjen e mëtejshme të këtyre grupeve në nëngrupe. Në çdo nëngrup do të dallojmë pjesëzat përkatëse, duke folur më hollësisht për ndonjerën ose disa prej tyre. Pjesëzat përdoren gjerësisht në gjuhën e folur dhe më pak në gjuhën e shkruar. Edhe çështja e shtresimit stilistikor të pjesëzave mund të bëhet objekt i një punimi të veçantë. Megjithatë hera-herës do të përpigemi të japim ndonjë vlerësim stilistikor për pjesëzat që do të analizojmë, por gjithnjë, pa i vënë detyrë vetes që të trajtojmë gjerësisht dhe të zgjidhim çështjen e shtresimit stilistikor të pjesëzave.

I. Ndër pjesëzat e grupit të parë që shprehin nuanca të përgjithshme kuptimore, jomodale mund të dallojmë; pjesëzat dëftore, pjesëzat përcaktuese, pjesëzat kufizuese a veçuese, pjesëzat e përafërisë dhe pjesëzat aspektive.

1. — *Pjesëzat dëftore*. — Pjesëzat dëftore *ja* (*qe, nji*) *na, namëta* shërbejnë për të treguarit a për dëftimin e një sendi, të një fenomeni, të një diçkaje që ndodh të shumtën në afërsi, përpara syve. Pjesëzat

qe, nji, janë vetëm të gegërishtes, ndërsa na dhe namëta përdoren rrallë P.sh.

«Ajo kish qenë në hekurudhë dhe ishte në nga të rejat aktive, pa na ç'i thotë Rushitit. . .» (K.G.SH.)

Pjesëza *ja* është e përdorimit të përgjithshëm, haset si në gjuhën e folur dhe në të shkruarën. Kuptimi i saj i zakonshëm është kuptimi i mësipërm dëftor. P.sh.

«*Ja* dhe lapidari nga ku 25 vjet më parë partizanët qëlluan. . .» (Sp. Pop. 1.3.1968 / «*Ja* zbriti nata. Nëm fjalën e shko në shtëpi (M. Kut. «Xinxifilua» f. 17) / «Shiroka — *ja* një oaz në rëzë të Taraboshit» (Z.P. 6.2.1968).

Pjesëza *ja* mund të përsëritet në fjalë të ndryshme, për të dëftuar më mirë a për të theksuar një për një sendet, veprimet, fenomenet që emërtohen nga këto fjalë, të cilavet pjesëza u referohet:

«*Ja* dhe këmbët e lidhura, *ja* dhe plagët, jodjo, fasho dhe njolla gjaku» (Sp. pop., 15.3.1968) / «. . . *ja* ku është lëmi i burrave, se si tha ai miku: *ja* sheshi, *ja* mejdani, *ja* dhe Sulo kapedani» (S. And. «Tregime. . .», f. 57).

Shpesh kjo pjesëz, gjithnjë duke e ruajtur kuptimin dëftor, përdoret kur zë fill kallzimi, tregimi a ligjërimi, kur folësi ndryshon temën, kur kujton a mendon për diçka të re. P.sh.

«. . . *ja* si ndodhi puna. . .» (J.X. «Lumi. . .», f: 107) / «Si do të pëshpërisin nësër baba? *Ja*: «Shameti e mori vesh nga e bija dhe. . .» (T. Laço «Njerëz. . .», Drita, 6.10.1968) / «Ke parë kokë Shameti ti apo jo? Kollaj të duket a? *Ja*, sot më drekë kish marrë mushkën dhe. . .» (Po ay, po aty).

Pjesëza *ja*, duke e zbehur ose duke e humbur kuptimin dëftor mund të marrë dhe nuanca të tjera kuptimore. Kështu ajo mund të marrë nuanca kuptimore përforcuese duke u përdorur me kuptimin menjëherë, tani, porsa, në kohën më të shkurtër, sidomos kur përsëritet (*ja, ja*) P.sh.

«Pse nuk fole — përshpëriti i vëllai — *Ja* tani — u përgjegj ajo» (T. Laço, po aty) / «A më prisni këtu sa të hyj. . .? *Ja* vajta e erdha» / (M. Kut. «Xinxifilua», f. 4) / «Ç'doni, ujë për kokën? *Ja* të shikojmë. . .» (Sp.pop. 15.3.1968).

Në gjuhën bisedore pjesëza *ja* përdoret edhe për nënvizimin e emocionit si dhe për t'i dhënë ligjërimin fuqi shprehëse. P.sh. «E po! *ja* gëzuar! Të hëngshim sheqer o panxhar!» (F. Gj. «Tana», f. 101) / «Si është puna?! Folë moj hapur! — *Ja* si të them. . . që të hoqën si drejtoreshë» (L. Prifti «Po drejtoresha?!», Puna, 16.4.1968) / «*Ja* thoni ju, a bëhet stan me lepuj?» (J.X. «Lumi. . .», f. 57).

Shumë nuanca kuptimore pjesëza *ja* i merr, kur shoqërohet me fjalë të tjera. Në disa raste pjesëza *ja* formon me këto fjalë bashkime të qëndrueshme, të cilat krahas nuancave kuptimore, që i sjellin fjalës a fjalisë së cilës i referohen, kanë edhe një farë ngarkese emocionale ekspresive.

Duke u shoqëruar me përemrat vetorë, dëftorë, me ndajfoljen *kështu*, pjesëza *ja* merr nuanca kuptimore përcaktontjese të afërta me ato të fjalës *pikërisht*. P.sh.

« — A ju kujtohet ai buldozeristi? — Po. . . — *Ja* ai e rrëmbeu mbrëmë natën» (B. My «Fluturzat. . .», f. 148) / «*Ja* kësaj i thonë dasmë, *ja* kësaj i thonë nuse», (M. Kut. «Xinxifilua» f. 124) / «*Ja* kështu lahet fyerja e varrit të vëllait» (M. Kut. «Tregime. . .», f. 141).

Me lidhëzën *kur* pjesëza *ja* formon një bashkim të qëndrueshëm

me vlerën e një pjesëze që përdoret, kur ndodh diçka që folësi s'e priste. Sinonim i këtij bashkimi të qendrueshëm është pjesëza *namëta*.

«E kish pritur dy muaj të tërë si ujët e ftohtë në piskun e vapës. . . Kur ja, ai erdhi pa pritur» (F.Gj. «Përmbysja», f. 159) / «Dy minuta më parë as re, as mjegull s'dukej kurkund. Kur ja, ajo na mbuloi të gjithëve. . .» (Sp.pop. 1.3.1968) *Namëta* si rrufeja që shkrep në të kthjellët nis e vrugullon tërë lugaja. . .» (M. Kut. «Xinxifilua», f. 20).

Këtë nuancë kuptimore pjesëza *ja* shpesh e merr edhe kur shpërqërohet me lidhëzën kundërshtore *po (por)*. Me këtë lidhëzë shoqërohen edhe bashkimet e qendrueshme *ja që, ja se* dhe i japin ligjërimin ngjyrim emocional. Bashkimi i qendrueshëm *ja që (ja që hë)* mund të përdoret dhe i pashoqëruar me këtë lidhëzë. P.sh.

«*Po ja*, pa pritur dëgjohen zile e këmborë. . .» (Z.p. 16.4.1968) / «*Por ja* ku na dalin disa zotërinj që hiqen si leninistë. . .» (Z.p. 15.3.1968) / «Për të mirën tonë e bën Partia, *po ja* që s'jemi mësuar ne dhe na duket sikur do të përmbysët bota» (R.Brah. «Tregime», f. 109) / «Kështu filloi zbritjen. . . *por ja se* bash përpara mbarimit. . . u flak lart» (Sp.pop. 16.1.1968) / «*Ja që* me një gol nuk kishte siguri». (Sp.pop. 24.4.1966).

Me ndajfoljen *pse* dhe lidhëzën *pra* pjesëza *ja* formon bashkime të qendrueshme me vlerën e një pjesëze. Këto bashkime të qendrueshme përdoren nga folësi, sa herë që ai do të bëjë një përmbyllje të atyre që ka thënë më sipër, sa herë që do të nxjerrë një përfundim a të rimarrë fjalët e thëna një herë. Këto bashkime të qendrueshme janë të gjuhës së shkruar. P.sh.

«Të mira nga «zoti», *po*, kanë parë të liqtë, shfrytëzuesit që rronin me djersën e të vobegtëve. *Ja pse* ne themi sot se jo perëndia por partia është kudo» (Z.p. 28.2.1968) / «*Ja pra* këtë aftësi të madhe që të komunikojë me njerëzit. . . e ka fituar Saliu» (Z.p. 29.2.1968).

Bashkimet e qendrueshme *ja ku, ja tek* kanë vlerën e një pjesëze përforcuese dhe emocionale-ekspresive. Përdoren nga folësi kur ai do të kumtojë e dorëzojë diçka me rëndësi. P.sh.

«Ti dashke nentqind dukatë të artë dhe vendin e Arbërit. . . *Ja tek* ike në tehun e shpatës sime» (M. Kut. «Tregime. . .», f. 224) / *Ja ku* po ta them» (F. Pa. «Mbi. . .», f. 67)

Bashkimi i qendrueshëm *ja dhe* përdoret si një pjesëzë e vetme dhe i jep fjalës a fjalisë së cilës i referohet nuancën e përkatësisë, shërben për të treguar një veprim a diçka të përfunduar, një send për të cilin është folur më parë, por që megjithatë na tërheq vëmendjen.

«*Ja dhe* çështja e inisiativës u zgjidh» («Host» nr. 3 1968).

Së fundi do thënë që pjesëza *ja* në thjeshtligjërim përdoret për t'i dhënë ngjyrim të fortë emocional (ironi, përbuzje, mospërfillje, kuptim, keqësues) të folurit. P.sh. Unë ta bëj këtë?; *Ja* ore. . .!; *Ja* ç'na qenka. . .!; *ja* dhe epikja jote kaq e pat! etj.

2. — *Pjesëzat përcaktuese*. Këto pjesëza përcaktojnë a saktësojnë më mirë kuptimin e fjalës a togfjalëshit të cilit i referohen¹⁸. Në këtë nëngrup hyjnë pjesëzat *që, mu(mu)* dhe disa pjesëza që qëndrojnë shumë afër ndajfoljeve si *pikërisht, tamam, bash, krejt*. (Për ndryshimet midis pjesëzave dhe ndajfoljeve folëm më sipër, prandaj nuk do të merremi më me këtë çështje).

Pjesëza *mu* është e mbarë shqipes. Varianti i saj *mun* është më i ri.

18) Shih Sh. Demiraj, *Morfologjia. . .*, Tiranë, 1963, f. 289 (Autori jep si pjesëza përcaktuese *pikërisht, tamam, mu, që*)

«Me vrasjen e Galip beut, komunistët i kanë rënë *mu* në shënjë». (Sh. Mu. «Para...» f. 186) / «*Mun* te port e Zylyftarit varur kok'e bash-nizanit...» (K.G.Sh.)

Ideja e një tërësie të përcaktuar e shprehur nga nyja e përparme e shumësit *-të*, që u paraprin numërorëve themelorë e përemrave të pakufishëm¹⁹, përcaktohet a saktësohet edhe më shumë me përdorimin e pjesës *që* (që të dy, që të tërë, që të gjithë etj.) p.sh. «Vërtet qehallarët *që* të dy kanë shkruar në Korçë, po...» «S.Sp. «Ata...», f. 121).

Pjesëza *pikërisht* është e gjuhës së shkruar, pjesëzat *krejt, tamam, bash* përdoren edhe në gjuhën bisedore dhe në gjuhën e shkruar. Këto pjesëza, sidomos pjesëza *tamam*, kanë edhe nuancën e krahasimit. P.sh.:

«Ngre një gur për të goditur këmbët e veta — thotë një proverb kinez — Reaksionarët e të gjitha vendeve janë *pikërisht* budallenj të tillë» (Mao Ce Dun «Citate», f. 79).

«Po *bash* në këtë Tiranë jetonte ai popull që shkrojti një kapitull të tërë në historinë tonë të lavdishme», (M. Shehu «Lufta...», f. 10) / «Nuk e bënte veten po i vinte shumë mirë që *tamam* Esmaja e tij dhe jo tjetër u bë brigadiere e re» (T. Laço «Njerëz...» Drita, 6.10.1968) / «Filluan të duken shtëpitë e para të veçuara të fshatit, të gjitha të reja, *tamam* shtëpi qyteti» (Sp.pop. 5.4.1966)

3) Pjesëza *veçuese a kufizuese*

Këto pjesëza shërbejnë si mjet theksimi a veçimi logjik për fjalët a togfjalshat të cilavet u referohen, u japin atyre nuanca kufizimi a veçimi. Në këtë nëngrup hyjnë pjesëzat: *vetëm, veç*, (përveç), *sidomos, veçanërisht*. Edhe këto pjesëza janë shumë të afërta me ndajfoljet.

Pjesëza *vetëm* është e mbarë shqipes, haset si në gjuhën e shkruar edhe në atë bisedore.

«Idetë e drejta të njeriut mund të vijnë *vetëm* nga praktika shoqërore». (Mao Ce Dun, «Citate», f. 218) / «Ai *vetëm* të hante e të pinte desh» (P. Marko «Qyteti...», f. 67).

Pjesëza *vetëm*, duke sjellë nuancat e kufizimit a të veçimit, ndihmon gjithashtu për të nxjerrë më shumë në pah marrëdhënjet kundërshtore midis fjalive. P.sh.

«Të kthehej? ç'fjalë ish kjo? Ajo s'ish më *vetëm* Ollgë, ajo kish dhe emrin partizane» (Sp.pop. 16.1.1968).

Bashkimët e qendrueshme me vlerën e një pjesëze kufizuese *vetëm që, vetëm sa*, mund të kufizojnë a veçojnë kuptimin e gjithë fjalisë. Këto bashkime të qendrueshme përdoren sidomos, kur pohimi i bërë nga folësi, kufizohet për nga ndonjë anë, nuk është pohim i plotë ose kur përjashtohet mundësia e vërtetimit të asaj që thuhet në fjalinë pas, apo të asaj që nënkuptohet p.sh.

«Ay *vetëm që* jep sinjalin për kryengritje, por nuk e bën kryengritjen». (K.G.SH.) / «Ç'i bënim ne ato zogj që zinin? *Vetëm sa* loznim me ta nëpër duar...» (K.G.SH.)

Kjo pjesëz mund të përdoret për të treguar se zgjatja në kohë dhe në hapësirë, ose se sasia e sendeve, frymorëve, objekteve të emërtuar nga fjala që kufizohet a veçohet nuk është e madhe. P.sh.

19) Po ay, po aty, f. 59.

«Marksit dhe Engelsit ishin *vetëm* dy veta dhe qysh atëhere ata deklaruan se kapitalizmi do të përmbysset në gjithë botën». (Mao Ce Dun «Citate», f. 83) / «Era i pengonte. Por ata për pesë minuta *vetëm* për pesë minuta u ndodhë në vendin e ngjarjes...» (Z.p. 3.2.1968).

Pjesëza *veç* ka përdorim më të kufizuar se sa pjesëza *vetëm*. Përdoret më shumë në gjuhën bisedore se sa në të shkruarën. Shumë rrallë haset pjesëza *përveç*, e cila është më mirë të mënjanohet nga përdorimi.

S'e haroj atë natë kur ajo partizane *veç* kollej». (Sp.pop. 16.1.1968) / «Por *veç* një dyshim e kam ama...» (N.Pr. «Lëkura...», f. 14).

Pjesëzat *sidomos* dhe *veçanërisht* janë shumë të afërta për nga kuptimi dhe për nga përdorimi. Që të dyja janë të gjuhës së shkruar. P.sh. «Hovi dhe mobilizimi i tyre në punë janë rritur *sidomos* tani, në prag të Kongresit». (Z.p. 1.9.1966) / «Kështu po ndodh *veçanërisht* në Azi ku revolucioni po zhvillohet me shpejtësi të madhe» (Z.p. 1.9.1966).

4) Pjesëzat e përafërisë

Këto pjesëza shërbejnë për ta paraqitur kuptimin e fjalës, së cilës i referohen, jo me saktësi, jo prerazi por përafërsisht. Këtë nëngrup e përbëjnë pjesëzat *afro*, *gati*, *nja*, *si nja*, *rrreth* dhe variantet *pothuajse*, *pothuaj*, (*pothua*), (*thua*se). Sh. Demiraj këto pjesëza (*pothuaj*, *pothua*, *gati*, *afro*, *nja*, *si nja*) i bashkon në një grup me zbutëset²⁰.

Përdorimi i pjesëzave *afro* dhe *gati* është mjaft i madh si në gjuhën bisedore dhe në gjuhën e shkruar.

«Ndenji aty *afro* një orë». (R. Nep. «Fusha...», f. 38) / «Sot këtu është arritur që të shkëputet nga gjiri i tokës *afro* dyfishi i mineralit...» (Z.p. 29.2.1968) / «Uashingtoni, ku më tepër se 14.000 parashutistë... ndihmojnë për shtypjen e egër të zezakëve, i ngjan një qyteti *gati të* vdekur» (Z.p. 5.7.1968).

Ndonjëherë pjesëza *gati*, për të dhënë më të fortë nuancën e përafërisë, përsëritet. P.sh.

«Të kërkosh t'i qëndrosh rob atij sistemi shkollor..., do të thotë të mos jesh dialektik, por idealist, ashtu siç do të thotë të jesh i tillë kur Mjedës kërkon t'i veshësh *gati-gati* virtutet e një njeriu socialist». (Z.p. 13.2.1968).

Pjesëzat *nja*, *si nja* janë të gjuhës bisedore. Përdoren para numërorëve (dy e lart) kuptimi i të cilëve nuk jepet me saktësinë e zakonshme por përafërsisht²¹.

«Do të shtroj *nja* dy rrogoza nën hardhinë» («Përpara» Korçë, 13.6.1968) / «Do dhe *nja* tri a katër ditë, po të mbajë koha ama» (F. Gjata «Tana» f. 20) / «*Nja* dy orë të mira pas buke, Ferriku i la njerzit pa mend (Sh.Mu. «Para...», f. 316).

Shumë afër me pjesëzat e përafërisë qëndrojnë pjesëzat *mend* (*ment*, *mënd*, *mënt*, *mënc*) dhe *desh* (*dish*) të cilat përdoren me kuptimin *gati*, *për pak*, *për qime*, sa herë që nuk ndodh diçka që pritej të ndodhte. P.sh.

«Kur e pa Kuma Marua kështu, si rrogeç ja plasi gazit... e *ment* i dualll sytë si gogëla dushku» (M. Kut. «Xinxifilua» f. 23) / «Për një grusht

20) Po ay, po aty, f. 290.

21) Po ay, po aty, f. 290.

kripë *desh* lamë kokën... *Desh* na përjashtuan fare nga rreshtat partizane, por...» (Z.r. 22.6.1968).

Midis pjesëzave të përafërisë dhe pjesëzave zbutëse, që do t'i grupojmë në pjesëzat modale-volitive, qendrojnë pjesëzat lidhëzore *si* dhe *sikur* që përdoren për të dhënë të zbutur e të përafërt kuptimin e fjalës së cilës i referohen. Ndonjëherë ato sjellin nuanca të pasigurisë, të dyshimit, të supozimit etj. Ideja e krahasimit tek pjesëza lidhëzore *si* është zbehur shumë e herë-herë s'duket fare. p.sh.

«Qafa e malit nga larg duket sikur po përleshet me erën dhe me mjegullën e ato *si* të mundura largohen...» (Z.r. 29.6.1968) / «Ty *sikur* të shoh pak *si* të çuditur» (M. Kut. «Netë...» f. 102) «Mos u bëni merak, s'mbeten ata, jo. Ja *sikur* kanë ardhur, ...» (Nend. nr. 11, 1968, f. 113) / «*Si* shumë shpejt profesor! Të kapërxehet dhe rekordi?!» (Sp. pop. 27.2.1968).

Së fundi mendojmë se në pjesëzat e përafërisë duhen grupuar edhe pjesëzat *disi*, *deri-diku* në përdorime të tilla si:

«Partizani dhe Universiteti zhvilluan një ndeshje *deri-diku* të ekuilibruar». (Sp.pop. 5.4.1966) / «Filluan ta lexojnë me mësuesin në krye *disi* duke u kapardisur» (Z.p. 13.12.1967) / «Me të lindurë fëmija *disi* ngushtë do bjeri shtëpia» (S.Ko. «Një tufë...» f. 59).

5. Pjesëzat aspektive

Një grup të veçantë përbëjnë pjesëzat *po*, *sa*, *sapo*, *që*, *qysh*, *deri* (*gjër*), të cilat ne do t'i quajmë pjesëza të aspektit ose aspektive, sepse përcaktojnë më mirë karakterin e rrjedhjes së një veprimi a procesi të shprehur nga folja. Edhe Sh. Demiraj i grupon këto pjesëza së bashku, po pa e përcaktuar qartë dhe pa e emërtuar këtë grup²².

Pjesëza *po* përdoret për të dhënë vazhdimësinë e veprimit të shprehur nga folja. Pjesëzat *sa*, *sapo* vënë më mirë në dukje «se veprimi i shprehur nga folja ka marrë fund pak kohë përpara çastit, që merret si bazë për marrëdhënjet kohore ose para një çasti të dhënë të kohës së shkuar»²³.

«Ç'ka Ymer Aga që *s'po* i ndjehet zëri?... ka ditë që *s'po* ha e *s'po* pi, *s'po* ve gjumë në sy, *s'po* i bie çiftelisë...» (M. Kut. «Tregime...» f. 55) / «Edhe mbledhja e ardhshme e Moskës do të vejë në shportën e plehrave siç vajti... mbledhja e Budapestit që *sapo* mori fund» (Z.p. 15.3.1968) / «Ish koha kur *sa* vinte e shtohet ndjenja e urrejtjes kundër pushtuesit» (Z.p. 27.5.1969).

Pjesëzat *që*, *qysh* shërbejnë për të treguar «pikënisjen e veprimit në kohë ose hapësirë»²⁴, ndërsa pjesëzat *deri* (*gjër*) «për të përcaktuar kohën kur mbaron a cakun ku merr fund veprimi i shprehur nga folja»²⁵. Këto pjesëza shpesh formojnë me lidhëza dhe ndajfolje lokucione lidhëzore e ndajfoljore.

«*Që* ditën që hyri prilli, zuri e këndoi bilbili» (K.G.Sh.) / «*Qysh* tani kanë përfunduar projektet e elektrifikimit të fshatrave që do të marrin dritë sivjet» (Z.p. 14.4.1968) / «... me këtë punë po merren tani çdo ditë, *që* nga orët e para të mëngjezit e deri vonë (Z.p. 15.6.1968).

22) Po ay, po aty, f. 290-291.

23) Po ay, po aty, f. 290-291.

24) Po ay, po aty, f. 290-291.

25) Po ay, po aty, f. 290-291.

6. Pjesëzat përforcuese

Këto pjesëza shërbejnë për të theksuar, për të përforcuar ose për të nxjerrë në pah kuptimin, idenë e konceptin e dhënë nga fjala, nga togfjalshi dhe nga fjalia²⁶. Në këtë nëngrup hyjnë pjesëzat *edhe, e, dhe, as që, bile, madje, deri* (gjer), dot. Pjesëzat *edhe, dhe, e* (kjo pjesëz haset shumë rrallë) janë homonime me lidhëzat bashkërenditëse shtonjëse dhe me pjesëzat ekspresive *edhe, dhe, e*. Bile në *edhë* lidhëz- *édhe* pjesëz kemi të bëjmë me homografe. Këto pjesëza përdoren në gjuhën e folur dhe të shkruar. P.sh.

«Po a të don vllau ndopak? — e pvetë plaka. — *Edhe* fort — ia pret çika» (K.G.SH.) / «*Edhe* dordolec le të shkonte në dasëm!» (Dh. Sh. «Kënga...», f. 210) / «*Dhe* dita më e gjatë gjen fundin në natë» (S.Ko. «Një tufë...», f. 17) / «Po ti mistrec, i mban anën, hë? U bëre *dhe* ti të japësh mendje...?» (N. Pr. «Cezma...», f. 81).

Nga sa duket edhe në shembujt e mësipërm vetë përforcimi i dhënë me anë të këtyre pjesëzave i afron ato me lidhëzat bashkërenditëse shtonjëse.

Bashkimi i qendrueshëm *as që* shërben për të dhënë një mohim më të fortë nga ay që jepet me pjesëzat e zakonshme të mohimit, prandaj edhe këtë bashkim me vlerën e një pjesëze mund ta quajmë pjesëz përforcuese, që ka kuptim të kundërt me pjesëzën *bile*

«Po vajza *as që* dëgjonte më...» (Sh.Mu. «Para...» f. 460) «Plaku *as që* e prishi rehatin kur shkoi para vetes aq herët në mëngjes fëmijët e agait» (A. Ab. «Tri...», f. 258) / «... *as që* ja vlente të kuvendonim fare» (V. Vi «Lumturia», f. 20).

Në vend të këtij bashkimi të qendrueshëm rrallë mund të përdoret pjesëza *nuk* e shoqëruar me lidhëzën *as p.sh.*

«Në Frakull të porsaardhurat u ndodhën përpara një të papriture që ndoshta *as nuk* u kishte shkuar ndërmend» (Z.p. 7.2.1968).

Pjesëzat *bile, madje* shërbejnë për të vënë në dukje rëndësinë e mendimit që vazhdon a pason pas një mendimi të shprehur më parë. Këto janë pjesëza plotësuese, përforcuese. Me përdorimin e tyre në fjali futet një farë momenti plotësues (suplementar), por nga kjo gjë vetë fakti i thënë a i treguar më parë nuk ndryshon. Kur shkalla e përforcimit është më e madhe pjesëza *bile* përsëritet. Pjesëza *madje* përdoret më rrallë, haset sidomos në stilin shkencor. P.sh.

«Por ja ku na dalin disa zotërinj që hiqen si leninistë, *bile* çfarë leninistësh, nga më «të pastërtit» të cilët pretendojnë se nuk duhet të ketë më polemikë...» («Karnavalet e Budapestit», Z.p. 15.3.1968).

«Nuk e shikon sa e gjatë jam? Më e gjatë se ti *bile*» (B. My «Fluturzat...», f. 147) / «Të jetë më i përmbajtur në bisedimet që do të zhvillohen. *Bile bile*, do të ish mirë... që të mos hapte gojën fare» (Sh.Mu. «Para...» f. 490) / «I vinte rëndë *madje* nga shumë shokë të tij» (Po ay, po aty, f. 361).

Me kuptimin e pjesëzave *bile, madje* përdoret edhe pjesëza *deri* (gjer).

Të dy këto variante të së njejtës pjesëzë përdoren sot edhe në gjuhën e shkruar dhe në gjuhën bisedore.

26) Ky grup i pjesëzave nuk është trajtuar deri më sot.

«Gjer vetë... Marksi dhe Engelsi nuk kanë pranuar që ata të kenë krijuar nga hiçi shkencën që i dhanë botës» (Z.p. 25.1.1967). / «Po kështu qindra kooperativistë të vjetër, *deri* edhe pleqtë merrnin rrugët e gjata (Z.p. 23.2.1968) / «Gjer librarinë në rrugë Mbretnore, dy herë ma mbyllnë ç'vëpër mizore» (Sh.Mu. «Epopeja...», f. 21).

Pjesëza përforcuese *dot* shërben për të theksuar mohimin, për ta përforcuar idenë e mundësisë dhe të pamundësisë së kryerjes së veprimit a vërtetimit të gjendjes së shprehur në fjali. Qëndron kështu shumë më afër pjesëzave modale-volitive. Përdoret shpesh në fjali pyetëse për të përforcuar eventualitetin e një mundësie. P.sh.

«Ama burrë qënke, nuk rregullon *dot* asnjë krevat» (B.My. «Fluturzat...», f. 28) / «Nuk ha *dot* e nuk pi *dot*,...» (M.Kut. «Tregime...», f. 55) / «S'të kandisën *dot*?...» (S. And. «Tregime...», f. 112) / «Ai sikur ta bënte me sy e të thosh me tallje: E, më mirrni *dot*?» (Z.r. 20.1.1962);

II. Në pjesëzat modale dallojmë këto nëngrupe: pjesëzat pohuese, pjesëzat mohuese dhe pjesëzat e dyshimit. Në pjesëzat modale-volitive dallojmë pjesëzat zbutëse.

1. Pjesëzat pohuese.

Pjesëzat pohuese, *po*, *posi*, *posi jo* (*po si jo*), *po se po*, *po që po*, *si urdhëron*²⁷ për herë të parë trajtohen si të tilla nga Sh. Demiraj (Më parë janë vështruar si ndajfolje).

Ndër pjesëzat pohuese pjesëza *po* ka përdorim më të gjerë dhe merr më shumë nuanca kuptimore. Ajo shërben për të pohuar a miratuar drejtësinë e një veprimi a dukurie, për të aprovuar diçka, për të dhënë pëlqimin për diçka. Ndonjëherë kjo pjesëzë shërben për të ripohuar a për të përforcuar pohimin e dhënë më parë në fjali. Në thjeshtligjërimit në vend të pjesëzës *po* përdoren pjesëzat pohuese *e*, *ë*, p.sh.

« — A ju kujtohet ai buldozeristi? — *Po*» (B.My. «Fluturzat...», f. 148). «Harrove sa herë ka krisur pushka dhe...? — Dikur *po*. Sot s'të lënë komunistët të bësh marrëzira të tilla» («Drita» 7.4.1968) / «I shikon kumbullat? — I shikoj, *po*» (S. And. «Tregime...», f. 315) / «...gjerdani me gurë të kuq shndriti si rubin. — Mua ma ke sjellë?! — më pyeti. — *E ty* — iu përgjigja unë» (B.My. «Fluturzat...», f. 76).

Pjesëza pohuese *po* shërben për të dhënë dhe idenë e identifikimit, mund të marrë kuptimin *taman*, *krejt*, *gjithashtu* etj. Në raste të tilla pjesëza theksohet mirë dhe shoqërohet me përemra e ndajfolje p.sh. *po ay njeri*, *po ajo gjë*.

«Klasa punëtore duhet të thotë fjalën e saj si duhet të jetë kjo inteligjencie, ... *Po* kështu klasa punëtore duhet të thotë si duhet të jetë ajo vetë». (Z.p. 11.10.1968).

Pjesëza *po* merr dhe nuanca kuptimore përforcuese:

«*Kleshçi*: Për së shpejti do të ngordhësh dhe mendjen *po* te paratë e ke». (M. Gorki «Fundurinat», f. 13 — përktheu V. Kokona)

Për të treguar vlerësimin e lartë që i bën folësi një frymori, një sendi a një objekti, emri që emërton këtë send, këtë objekt a frymor përsëritet, duke marrë pjesëzën pohuese *po* në mez. Kjo formë të shpre-

27) *Po ay*, *po aty*, f. 292.

huri haset sidomos në letërsinë tonë gojore dhe i jep ligjërimin fuqi të mëdha shprehëse. Vetë vlerësimi përmban në vetvete dhe qëndrimin e fortë emocional të folësit dhe ndryshon, në këtë drejtim, nga vlerësimi që mund të shprehet gjuhësisht me anë të një mbiemri cilësor në shkallën sipërore. P.sh.

«Kam patur të dhënë e të marrë me tët vëlla. Burrë *po* burrë ka qenë». (M.Kut. «Xinxifilua», f. 157) / «Verë *po* verë bëjnë këto vreshtat e Hanit» (M.Kut. «Netë...», f.81).

Pjesëza pohuese e përngjitur *posi*, bashkimet e qendrueshme me vlerën e një pjesëze pohuese *posi jo* (*po si jo*), *po se po*, *po që po*, kanë përdorim më të kufizuar se sa pjesëza *po*. Ashtu si përsëritja e pjesëzës *po* (*po po*, *po(mor)po* etj.) edhe pjesëzat e mësipërme përdoren, kur folësi e ndjen të nevojshme të aprovojë me forcë atë çka është thënë a për të cilën është pyetur, ose, kur folësi do të pohojë vërtetësinë e diçkaje që vihet në dyshim p.sh.

«— Mos bre burrë! ... u çudit nga këto që dëgjoi Ferihat Tafili... — *Po*, *po* ia ka thënë këtë edhe mbretit, por...» (J.X. «Lumi», f. 57). «Unë duhet të jem i gatshëm apo jo? — *Po more po*, veç se më duket, si e tepëruar. Ai tregoi se për anën materiale *po se po* duhej t'i kishte të gjitha në rregull». (Sp. pop. 24.4.1966) / «*Po* ti më do? — *Posi*» (S. And. «Tregime...», f. 133) / «Ti s'ke vënë verore? — më pyeti — Kam vënë *posi*» (Po ay, po aty, f. 134). / «*Po si jo* moj cupë e babajt, thuaj ti, pse ta mbash fshehur» (N. Pr. «Çezma...» f. 92).

Pjesëza *siurdhëron* përdoret për të treguar aprovimin e plotë të folësit për atë që thuhet, gadishmërinë e bindjen e tij ndaj asaj që i kërkohet. Përdoret sidomos në gjuhën e ushtarakëve.

«— I ke menduar mirë të gjitha? — *Siurdhëron*. Vështirësia qëndron vetëm tek materialet» (10 Ko. nr. 8, 1968, f. 16). / «— Të bëhet apeli. — *Siurdhëron*» (10 Ko. nr. 8 1968, f. 27).

Të gjitha pjesëzat pohuese nga sa mund të shihet edhe në shembujt e sjellë më sipër, mund të përdoren si fjalë olofrastike.

Pjesëzat pohuese, sidomos *posi*, *posi jo* (*po si jo*), *si urdhëron* në kontekste të caktuara dhe me intonacion të veçantë përdoren për të sjellë nuanca të tilla kuptimore si mosbesim, përçmim, kundërshtim, ironi etj.

«— Mos dysho tek unë — ja prit! Asimaqi — jam i mirë unë. — I mirë *posi* për të pirë në kupë të hudhrave. (S. And. «Kandili...», f. 45) / «Nastja: Hiç mos u bëj merak... ta fshij unë, *posi!*» (M Gorki «Fundurnat», f. 8, përkthet V. Kokona).

2. Pjesëzat mohuese

Pjesëzat mohuese të shqipes janë *jo*, *nuk*, *s*, *mos*.

Pjesëza mohuese *jo* përdoret për të mohuar një a më shumë mendime të shprehura nga një tjetër, për të treguar kundërshtim ndaj diçkaje, mos pëlqim a mosrënje dakord. Në dallim nga pjesëzat e tjera mohuese pjesëza *jo* përdoret edhe si fjalë olofrastike. P.sh.

«— A e morët vesh se ç'ndodhi mbrëmë...? — *Jo* nuk kemi marrë vesh gjë.» (B. My. «Fluturaz...», f. 48) / «— Ç'bën vallë babai tani? — Është kthyer në kraun tjetër dhe gërhet — *Jo* s'është ashtu! Unë e di që është i shqetësuar! (T. Laço «Njerëz...», Drita, 6.10.1968) / «Dorëzohuni!!! — *Jooo!* ulëriti Rexhepi. Qëlloni shokë! (S. And. «Tregime...», f. 75). / «Benzina tret yndyrnat, por than dorën dhe krijon plasaritje, kurse sapuni mekanik, *jo*» (Z.p. 4.2.1968).

Pjesëza *jo* mund të përdoret për të mohuar vetëm kuptimin e një fjale dhe *jo* të të gjithë fjalisë, si të thuash, pranohet ajo çka thuhet në fjali, por duke kufizuar a përjashtuar diçka. P.sh.

«Tregona gjësend, o Ilush! Tregona një histori trimash, po *jo* të zamanit». (S. And. «Tregime...», f. 78).

Për të përforcuar mohimin pjesëza *jo* mund të përsëritet, mund të përdoret me pjesëzat e tjera mohuese në fjali si dhe me fjalë me kuptim mohues (asnjë, asgjë, aspak, kurrë etj.), mund të shoqërohet me ndonjë fjalë modale (*sigurisht, natyrisht, patjetër* etj.). Mohim të fortë japin edhe bashkimet e qendrueshme *jo që jo, jo se jo*. P.sh.

«Gjuajti jashtë, *jo*. Atëhere do të thoni ju topi rrahu shtyllën. *Jo, jo*. E po portjeri e priti. E po *jo de jo*». (Sp. pop. 9.2.1968) /«Unë të kthehem?! *Jo* doktor mos u lodhni me mua» (Sp. pop. 15.3.1968). /«A të dhëmb — *Jo*, aspak — u përgjigja unë me gëzim të shtirur. (Pion. 14.2.1968); /«Po a do ta lëmë të vazhdojë në këtë rrugë? Sigurisht *jo!*» (Pion. 21.2.1968).

E përdorur në pyetje pjesëza *jo* shërben për të dhënë nuancat e pasigurisë e të supozimit.

«Ju kini mbetur prapa ajo *jo?*» (Z. p. 22.3.1966)

Pjesëza *jo* përdoret në pyetje retorike që japin një *qortim, këshillë, urdhër, habi* etj.

«Ke parë kokë Shameti ti apo *jo?* Kollaj të duket a?...» (T. Laço «Njerëz...», Drita, 6.10.1968 /«S'di por i fut si shumë hundët në punët e mija. Dëgjon ti apo *jo?* Këtu në Polis një gjel këndon». (Z.p. 29.2.1968).

Së fundi, pjesëza *jo*, shpesh e shoqëruar me pasthirma, i jep ligjërimin ngjyrim emocional, p.sh.

«Dhe plaku iu kthye së shoqes me qesëndi: — *Jo re!* Dashke të shkosh në dasëm...» (Drita, 7.4.1968).

Pjesëzat mohuese *nuk, s*, janë sinonime për nga kuptimi dhe për nga përdorimi. Historikisht *s* është më e vjetër. Stilistikisht lidhet më shumë me gjuhën bisedore «e si e tillë është më pak e hollë se *nuk*. Përveç kësaj *nuk* ... edhe fonetikiisht paraqitet më e plotë, më ekspresive e akustikiisht më e ndishme se *s*-ja, prandaj ka zënë vend sidomos në gjuhë të shkrimit»²⁸. Të dyja këto pjesëza përdoren për të mohuar vërtetësinë e një ngjarjeje, të një gjendjeje, të një dukurie etj. Mohimi përforcohet, po qe se dhe këto pjesëza shoqërohen me fjalë me kuptim mohonjës, me pjesëzën *jo*, me pjesëzën *dot* si dhe kur përsëriten para disa fjalive që vijnë njëra pas tjetrës. Ky mohim zbutet, kur përdoret pjesëza *para*. P.sh.

«Ne komunistët *nuk* i fshehim *kurrë* pikëpamjet tona politike» (Mao Ce Dun «Citate», f. 25).

« — S'ke frikë se të mbërthejmë me krahët për tokë? — *Jo s'kam*» (M. Kut. «Tregime...», f. 65). /«Për të gjithë komunistët e vërtetë tani më është aksiomë se pa luftë, pa polemikë *nuk* ka revolucion, *nuk* ka parti marksiste-leniniste, *nuk* ka komunizëm». («Karnavalet e Budapestit» Z.p. 15.3.1968).

Edhe pjesëza *mos* përdoret për të mohuar atë çka shprehet në fjali. P.sh.

«... Po më sheh se çdo t'i bëj! Mos pandehë ai se ai është». (Z. Sako «Medalja e Trimërisë», A.L.SH.) /Dhe kur rriteshin, djemtë merrnin

²⁸) E. Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe*, në «Studime filologjike» nr. 4, 1965, f. 48.

udhën e mërgimit, shpesh herë për të *mos* u kthyer më». (Z.p. 25.2.1968).

Shpesh kjo pjesëz u paraprin foljeve në mënyrë urdhërore e kjo bën që mohimi të paraqitet në formën e një dëshire, mallkimi, urimi, kërkese, lutjeje, urdhëri, këshille, udhëzimi, qortimi, moslejimi etj. P.sh.

«— *Mos* ma nxirr, Muj, djalin nga shtëpia! — Hajt moj grua mos qaj të gjallët që duan të dalin të çetojnë bjeshkëve...» (M. Kut. «Tregime ...», f. 117). /«*Mos, mos* kësisoj, bir, se s'bën» (J. X. «Lumi...», f. 37).

Edhe pjesëzat *s, nuk, mos* përdoren në pyetje retorike për të dhënë nuanca të ndryshme kuptimore emocionale (ironi, qortim, përbuzje, përkëdhelje etj.) dhe për të shprehur pohim të fortë. P.sh.

«*Nuk* e shikon që nuk na del as për të ngrënë? *Nuk* e shikon që punojmë gjithë ditën për një krodhë bukë të thatë?» (Pion. 22.1.1968) / «Po ju s'patët turp që gëzoheshit dhe brohorisnit?» (Sp. pop. 11.1.1966) / «A *nuk* duan prindërit fëmijën?» (Pion. 22.1.1968). /«*Mua* të *mos* më vijë ndoresh për këpucë?» (M. Kut. «Xinxifilua», f. 156).

Pjesëzat mohuese *s, nuk, mos* dhe pjesëza trajtëformuese me kuptim mohues *pa*, shërbejnë për të formuar antoniminë në frazeologjizmat e gjuhës shqipe (p.sh. ma ha mendja -s'ma ha mendja; merre me të mirë -*mos* e merr me të mirë: duke marrë parasysh -*pa* marrë parasysh etj.)²⁹. Antonimia në këto frazeologjizma, sikurse dhe antonimia e fjalëve me pjesëzën *jo*, është më e dobët se në frazeologjizmat antonime pa pjesëza mohuese.

Së fundi, do thënë që në gjuhën shqipe takohen ndërtime të tilla në të cilat, megjithëse hasen dy pjesëza mohuese, — njera, pjesëza *nuk* ose *s*, para një foljeje modale, dhe tjetra, pjesëza *mos*, para një foljeje në mënyrën lidhore, — prapëseprapë jepet një pohim. Ky pohim është pak a shumë i zbutur. P.sh.

«Revizionistët... *nuk* mund të *mos* e merrnin parasysh tendencën e përgjithshme të masave punonjëse në vendet e tyre të cilat u ngritën kundër agresionit në Çekoslovaki...» (Z.p. 8.10.1968).

3. Pjesëzat e dyshimit.

Pjesëzat e dyshimit *ndofta, (ndoshta), mbase, kushedi, vallë, se mos, sos* shërbejnë për t'i dhënë mendimit të shprehur a pyetjes së hedhur nga folësi nuancën e dyshimit, të ndrojtjes, të pasigurisë, të mundësisë etj. Pjesëzat *ndofta, (ndoshta), mbase, kushedi* janë sinonime.

E fundit përdoret rrallë, të tjerat hasen gjerësisht si në gjuhën e shkruar dhe në gjuhën bisedore. P.sh.

«*Mbase* kemi dhe gabime po i gjejmë në mes tonë» (Z. Sako «Medalja e trimërisë» A.L.SH. f. 353) /«... ditë të bukura kanë me ardhë! Por, *ndoshta*, unë s'do i gëzoj, o bir...» (Ll. Siliqi «Miku» A.L.Sh. f. 475) /«... *mos* ma merr Omerin në bjeshkë. *Ndofta* e merr malli të flerë në prehërin tim, *ndofta* e merr malli të pijë në gjirin tim.» (M. Kut. «Tregime...», f. 117).

Pjesëza *ndofta* e toskërishtes së sotme ka dalë nga pjesëza e gegërishtes *ndoshta*³⁰).

29) Shih për këtë: J. Thomaj, *Probleme të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, «Studime filologjike», nr. 2, 1964.

30) E. Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe* në «Studime filologjike» nr. 4, 1964, f. 92.

Pjesëza *vallë* përdoret sidomos në fjalitë pyetëse, shpesh e shoqëruar me pjesëza e fjalë të tjera, ose për të përforcuar dyshimin ose për t'u dhënë pyetjeve ngjyrim ekspresiv emocional. P.sh.

«Dëgjoi një pëshpëritje të butë, po prapë nuk e kuptoi dot ç' mundonte ashtu *vallë* gëzimi apo brença?» (T. Laço «Njerëz...», Drita, 6.10.1968) / «Mos *vallë* mendojnë se janë të përparuar se e bëjnë bukën dhe s'kanë ç'u duhen tokat e reja?» (Z.p. 13.2.1968) / «Shikonte arën dhe i kish hyrë merakut se ç'*vallë* do mbaronin gjer në mbrëmje» (N.Pr. «Çezma...», f. 40).

Edhe pjesëza mohuese *mos*, mund të shërbejë për të vënë në dyshim vërtetësinë e një ngjarjeje a të një dukurie; kemi të bëjmë në këto raste me një përdorim a kuptim të veçantë të pjesëzës mohuese *mos*. Dyshimi i shprehur nga kjo pjesëz shpesh gërshetohet me pyetjen, me dëshirën për të ditur diçka.

«Shiko se *mos* ju bëjnë sytë» (Dh. Sh. «Çlir.» II, f. 8) / «Shok-o, *mos* më hajë qeni! — përsëriti mësuësja» (S. Sp. «Afërdita...» f. 4) / «Marina! Ç'ke moj bijë që qan? *Mos* je e sëmurë? — e pyeti duke i ndenjtur pranë.» (F. Gj. «Përmbysja», f. 18).

Në pjesëzat e dyshimit po grupojmë edhe bashkimet e qendrueshme *mos a mos* dhe *se mos* që kanë zakonisht vlerën e një pjesëze të dyshimit.

Bashkimi i qendrueshëm *mos a mos*, i formuar nga përsëritja e pjesëzës *mos* me elementin lidhës *a* në mes, shërben për të dhënë një dyshim të shkallës së lartë. Ka përdorim shumë të kufizuar. P.sh.

«I lidhë e i zgjidhë magjira... *mos a mos* merr malet» (M. Kut. «Netë...», f. 152).

Pjesëza *mos* formon me pjesëzën lidhëzore *se* (ish lidhëza ftilionjëse *se* në fjali kryefjalore dhe kundrinore) një bashkim të qendrueshëm me vlerën e një pjesëze të vetme që sjell në fjali nuanca të dyshimit, ironisë, nënvleftësimit, përbuzjes, shakasë etj. P.sh.

«*Se mos* të prishet mendja e kërkon të na bëhesh patrik! — tha babai dhe ia krisi gazit.» (K.G.SH.) / «... Kur kthehej nga gjahu me duar bosh, vezët prapë se prapë t'i kërkonte... *Se mos* i donte për të ngrënë që të thuash hajde deh» (J.X. «Novela», f. 125) / «*Se mos* ke punë tjetër zotërote — tha ai me tallje» (F. Gj. «Përmbysja», f. 9) / «*Se mos* la gjë mangut xha Shemeja!... Sa për xha Shemen s'kam ç'të them, por sa për Vërtokun ai kështu e ka: ndryshe flet në sy ndryshe prapa krahëve. *Se mos* nuk e njeh!» (S. Sp. «Afërdita...», f. 48).

Kuptim shumë të afërt me bashkimin e qendrueshëm *se mos*, ka edhe pjesëza *sos* që haset në gjuhën bisedore e në thjeshtligjërime. P.sh.

«Ma prure kafenë e ma le te dera, *sos* urdhëron zotrote të të sjell të tjera.» (K.G.SH.) / «*Sos* ke ardhur këtu për të ngrënë qoftë apo për të fjetur — thotë mënjanë Mefaili» (M. Shehu «Kujtime...», f. 14) «Çfarë pune ke tjetër ti... *sos* ke ara që të mirresh me rosat» (J.X. «Lumi...» f. 213) /

Fjalëza *sos*, duke u përsëritur, mund të formojë lokucion lidhëzor. P.sh.

«*Sos* gomari që na ngordhi, e *sos* mizati» («Ylli, nr. 8, 1968, f. 17) / «Shihni Adhamutnë e mjerë. *Se* ç'heq fatziu me grua, *sos* qirinë do t'i mbajë, *sos* të shara të durojë.» (K.G.SH.)

4. Pjesëzat modale-volitive mund t'i trajtojmë të gjitha së bashku me grupin e pjesëzave zbutëse.

Pjesëzat zbutëse *pa, as, le, para* përdoren për të zbutur kuptimin e fjalës së cilës i referohen³¹.

Pjesëza *pa* zbut urdhërin a kërkesën e shprehur nëpërmjet foljes në mënyrën urdhërore, lidhore, e më rrallë në dëftore. Është pjesëz e gjuhës bisedore. P.sh.

«Pa dëgjoni o shokët e mij!» (M. Kut. «Tregime...», f. 43)/ «*Pa* dale, *pa* dale njëherë ta marrim shtruar (J.X. «Lumi...», f. 175).

Edhe pjesëza *as* përdoret për të zbutur urdhërin, kërkesën a lutjen e folësit. Është formuar nga përngjitja e pjesëzës ekspresive-emocionale *a*, e përdorur në fjali mohuese, me pjesëzën *s* të kësaj fjalie. Kjo pjesëzë i jep gjallëri e bukuri ligjërimin a tregimit. Përdoret në gjuhën bisedore dhe të shkruar. Haset sidomos në poezinë popullore. Ndonjëherë vendoset pas trajtave të shkurtëra të përemrit vetor dhe foljor, para të cilave qendron zakonisht. Shembuj:

«O çoban o gunëdhirë, *as* më ther një dash të mirë...» (K.G.SH.)/ «*As* ma jep, Minush gjerdhanë, *as* ma qep yllin në gji, *as* ma jep ti maliherin, se do shkoj me partizanë» (F. Gj. «Kënga e partizanit Benko» A.L.SH.)/ «*As* e lini këtë muhabet e na tregoni ndonjë përrallë...» (F.Gj. «Përmbysja», f. 26) «Ju që niseni për lule, shoqe të mijëza, merrmëni *as* edhe mua, nëpër pyje e korijëza» (K.G.Sh.).

Kur përdoret në pyetjet retorike, kjo pjesëz mban një ngarkesë të madhe emocionale-ekspresive. P.sh.

«Kur djemtë duan të shfaqin dashurinë — u hodh një tjetër — *as* më marrin mua?» (K.G.SH.).

Pjesëza *le* përdoret gjithashtu për të zbutur urdhërin a kërkesën e folësit, për ta paraqitur këtë kërkesë a urdhër në formën e nxitjes, të lejimit, të urdhërit, të udhëzimit, të pëlqimit a të rënjes dakord, të veprimtimit etj. Krahas këtij funksioni kjo pjesëz mund të luajë dhe funksion fjalëformues, sa herë që shoqërohet me folje të mënyrës lidhore të vetës së tretë njëjës dhe shumës, për të sajuar format e mënyrës urdhërore të këtyre foljeve në këto veta (*le* të shkojë, *le* të shkojnë). P.sh.

«*Le* ta mbajmë lart flamurin e tyre dhe të shkojmë në rrugën e skuqur me gjakun e tyre» (Mao Ce Dun «Citate» f. 193) «Drejt e kini *le* të dalin gratë në ballë të dasmorëve» (Drita, 7.4.1968) /«Tani *le* të ndahemi...» (Sp. pop. 15.1.1968) /«... mos o djalë se do shkosh fir... — *Le* të shkoj fir. Nuk dua jetë me turp». (S. And. «Tregime...», f. 30).

Pjesëza *le* që është një bashkim i qendrueshëm që përdoret kur ajo që është thënë konsiderohet si e tepërt e nuk ja vlen të flitet më për të. Ky bashkim i qendrueshëm ka edhe një ngarkesë emocionale të dukshme. P.sh.

«Po Myneveri e pëlqente këtë krushqi? E kush e pyeste atëhere atë. *Le* që babai nuk pyeti asnjëri, për këtë krushqi» (B.My. «Fluturzat...», f. 19). /«Traineri i tij» thotë për Andrean se është një gjimnast me prespektivë. *Le* që rezultati flet vetë». (Sp. pop. 5.4.1966).

Në pjesëzat zbutëse mund të grupojmë edhe pjesëzën *para* që përdoret vetëm e shoqëruar me pjesëzat mohuese *s, nuk*, për të zbutur mohimin, për ta paraqitur atë jo të prerë. P.sh.

«Pardesyja e hollë *s'para* e mban dot erën» (A.Ab. «Tri...», f. 136) / «Dasmat *nuk para* bëhen në fshat në këtë kohë» (F Gj. «Tana», f. 34).

31) Sh. Demiraj, *Morfologjia...*, 1963, f. 290.

III. Pjesëzat emocionale-ekspresive

Këto pjesëza mund t'i ndajmë në tre nëngrupe: 1. — Pjesëza emocionale-ekspresive 2. Pjesëza ekspresive që vijnë nga shndërrimi funksional i lidhëzave, 3. Pjesëza thirrmore apo eksklamative. Numri i këtyre pjesëzave është shumë i madh, përdorimi i tyre mjaft i dendur. Megjithatë për to nuk është folur qoftë edhe në tekstet tona shkollore. Tek Sh. Demiraj kemi përpjekjen e parë për të dalluar pjesëzat ç, sa dhe seç si një grup më vete. («Morfologjia...» f. 291).

1. Pjesëzat emocionale-ekspresive *a*, *po*, *e po*, *ama*, *pa*, *se*, *seç*, *ç*, *ë*, *de*, *aspo*, *pa le*, theksojnë më shumë emocionin e thënjes, sjellin në kuptimin e përgjithshëm të fjalisë nuanca të tilla që lidhen me qendrimin emocional të folësit, ndaj asaj që thotë, shtojnë fuqinë shprehëse të ligjërit. Ky grup i madh i pjesëzave përdoret në gjuhën bisedore e sidomos në thjeshtligjërime. Përdorimi i gjerë i këtyre pjesëzave në gjuhën bisedore e në thjeshtligjërime, përbën një nga veçoritë që dallojnë këto stile nga ay i gjuhës së shkruar. Vetëm në raste të veçanta, kur folësi kërkon të japë shumë të fortë qendrimin e tij emocional, këto pjesëza mund të përdoren dhe në gjuhën e shkruar.

Të dallosh pjesëza vetëm emocionale dhe pjesëza vetëm ekspresive është shumë e vështirë, me që rritja e fuqisë shprehëse sjell me vete edhe ngjyrimin emocional të tij. Prandaj është më mirë që pjesëzat ekspresive dhe emocionale të vështrohen si një grup i vetëm.

Pjesëza *a* është quajtur me të drejtë pjesëz pyetëse sepse përdoret kryesisht në fjalitë e pyetjes së drejtë dhe të zhdrejtë. Kjo pjesëz në sajë të intonacionit të përdorur, të kontekstit, të kushteve të ligjërit sjell në kuptimin e përgjithshëm të fjalisë nuanca kuptimore nga më të ndryshmet (*dyshim*, *pasiguri*, *ironi*, *qortim*, *përbuzje*, *kërcënim*, *përkëdhelje* etj.).

«A e marrët vesh se ç'ndodhi mbrëmë në mëhallën tonë?» (B. My. «Fluturzat...», f. 48)/ «Eja këtu të mërkurën. E si thua *a* do të vish?» (Sp. pop. 11.1.1966)/ «Kështu janë të rinjtë *a*?» (Sh. Mu. «Para...», f. 112). /«*A* po don mysafir, o i zoti i shpisë!» (J.X. «Lumi...», f. 155).

Përdorim të gjerë ka pjesëza *a* në fjalitë e pyetjeve retorike. «*A* ka fjalë më të rëndë për shqiptarin se sa t'i thuash se e ka shkelur besën?» (M. Kut. «Tregime...», f. 30).

Pjesëza emocionale-ekspresive *po*, homonime me pjesëzën pohuese *po* dhe me pjesëzën aspektive *po*, haset sidomos në fjalitë e pyetjes së drejtë dhe të pyetjes retorike, rrallë në fjali të tjera. Është e gjuhës bisedore. P.sh.

«Do të pyesë ndonjeri: *Po* Myneveri e pëlqente këtë krushqi?...» (B. My. «Fluturzat...», f. 59) /«*Po* ju nuk patët turp që gëzoheshit dhe brohorisnit?» (Sp. pop. 11.1.1966).

Në ligjërime kjo pjesëz përdoret shpesh kur folësi kërkon të dijë a të mësojë diçka të re, veç atyre që janë thënë a nënkuptuar. Në raste të tilla pjesëza emocionale-ekspresive *po* jep idenë e një kundërshtimi të lehtë, merr kuptimin *mirë*, *po(por)* p.sh.

«Pushon kënga, shuhet gazi... Asnjë s'guxon të flasë. *Po* ç'i thotë nusja vjehrës?» (M. Kut. «Tregime...», f. 143) /«Ty të kemi kryetar të këshillit ndaj ty të përket të ecësh në krye. — *Po* emancipimin e gruas *kü* e latë? — bëri shaka një i ri» (Drita, 7.4.1968).

Ky kuptim i afërt i kësaj pjesëze me lidhëzen bashkërenditëse *por*

do shpjeguar, për mendimin tonë, me prejardhjen e saj nga kjo lidhëz. Në përdorimet e mësipërme të pjesëzës *po*, do të jetë kaluar nga përdorimet e vetë kësaj lidhëze, si pjesëz emocionale-ekspresive në raste të veçanta. P.sh.

«Mbi të gjitha sistemi ynë shkollor duhet ta bëjë arësimin, kulturën, shkencën, pronë të të gjithë popullit e në radhë të parë të klasës punëtore. Por mos vallë duhet hedhur poshtë gjithë sistemi arësimor që kemi? (Z.p. 11.10.1968) /«Po a është e mundur që vajza t'i propozojë djalit?» (B.My. «Fluturzat...», f. 7).

Por ka edhe mjaft raste kur lidhja e pjesëzës *po* me lidhëzën bashkërenditëse kundërshtore mezi dallohet ose s'duket fare e pjesëza *po* përdoret kryesisht për elokuencë. P.sh.

«Po ju, mor kolopuçat e babajt, si e kaluat sot?» (Po ay, po aty, f.12). «Pastaj Piloja iu kthye të tjerëve: — Po, keni parë ju?... për fshatin ky lumi i Trokthit është i vdekur, për mua po del i gjallë e i bekuar» (J.X. «Lumi...», f. 163). /«Ku do vesh Benko? Po mua, s'të vjen keq për sytë e mi që s'do shohin syt e ty?» (F. Gj. «Kënga e partizanit Benko» A.L.Sh. 469). /Bëji të fala shumë nga ana ime. Po Agimin e Avniun si i ke?» («Shqiptarja e re» nr. 5. 1968).

Idenë e një kundërshtimi të lehtë si dhe të përmbylljes së asaj që është thënë e është nënkuptuar, gjithnjë të shoqëruar me ndiesinë e emocionin e folësit e jep edhe bashkimi i qendrueshëm e *po* p.sh.

«— Unë nuk jam dakord — ja priti shkurt kryetari. — E po zot në kooperativë jemi ne... ti, shoku kryetar, je shërbëtor i ynë». (Z.p. 29.2.1968). /«E po! Ja gëzuar/ Të hëngshim sheqer o panxhar!» (F. Gj. «Tana», f. 101). /«E po, pyetja u bë përgjigja u dha secili mbeti në punën e vet». (10 Ko. nr. 1 f. 14).

Pjesëza *ama* përdoret shumë dendur veçanërisht në thjeshtligjërimit. Ajo i sjell kuptimit të përgjithshëm të fjalisë a fjalës në cilës e referohet nuanca të mospërfilljes, të nënvleftësimit, të vlerësimit të lartë, të ironisë, të përcmimit etj. P.sh.

«Ama zoti Florismart na qenka?...» (K.G.Sh.) /«Ama kooperativë qenka, do të thotë bota kur të na marrin vesh. Ama kryetar paski!» (F. Gj. «Tana», f. 111). «Ti do të geshësh e do të thuash: Ama burrë qenke, nuk rregullon dot asnjë krevat» (B.My. «Fluturzat...», f. 28) /«Ama qe për kokën e qeve!» (F. Gj. «Tana», f. 49). /«Ama dhe ty o kumtër të gjet një punë» (J.X. «Lumi...», f. 165).

Shpesh pjesëza *ama* jep idenë e një farë veçimi a theksimi, herë të tjera merr kuptim të afërt me atë të lidhëzës *por* p.sh.

«Ah, Adem... sa të pjell mendja, po të pjell për të keq *ama...*» (N.Pr. «Lëkura...», f. 43) /«... dhimset jeta, po si do të vejë filli nuk e di. Ama nuk është e drejtë që punën tënde, lumturinë tënde ta lidhim me sëmundjen time» (V.Vi. «Lumturia», f. 32).

Pjesëza emocionale-ekspresive *pa*, homonime me pjesëzën zbutëse *pa*, është e gjuhës bisedore dhe thjeshtligjërimit. Përdoret për të përforcuar ndonjë ndjenjë të folësit.

«A të kripsha mëntë, *pa!*» (J.X. «Lumi...», f. 202) /«Ku e gjeti *pa*, sonte ditë me nishan!» (J.X. «Lumi...», f. 348) /Dale *pa*, do ta shikosh cili jam unë» (M. Kut. «Xinxifilua», f. 119).

Në raste të tilla në vend të pjesëzës *pa* mund të përdoret edhe pjesëza *se* sidomos në gegërishte. (Pjesëzën *pa* e ka pasur dhe gegërishtja).

«Tash? ke ne vrapin/ si qent për petlla/ t'na hjekin sytë/ me na vu vetlla/... Po kush si njeft *se?*» (Sh.Mu. «Epopeja...», f. 19) «Dhe kur e

bën babai këtë se? Një ditë më parë se sa të bisedojmë në mbledhje» (T. Laço «Njerëz...», Drita, 6.10.1968).

Pjesëza *pa* ndonjëherë përdoret vetëm për t'i dhënë ngrohtësi e gjallëri të folurit.

«*Pa* na bëri zonja mace ca kotele të vegjël laraganë» (M. Kut. «Xinxifilua» f. 232). /«*Pa* me gusht bashkë/ ikën dhe vapa/ zoti na ruajt / ç'dimër vjen prapa!» (Sh. Mu. «Epopeja...», f. 12).

Pjesëza *seç* (*se ç*) përdoret për të theksuar ndjenjën e kënaqësisë, habisë, gëzimit. Haset sidomos në poezinë popullore. P.sh.

«Vet Enveri asht këtu, /ti më të ke bisedue.../ *seç*³² ka ngri plaku në kambë, /fërkon sytë dhe s'beson». (Ll. Siliqi «Miku» A.L.Sh. f. 478) «Ç'u zbardhë malet u zbardhë / nga çdo anë *seç* na ardhë/ shqiptarët gunëbardhë» (K.G.Sh.).

E afërt me pjesëzën *seç* për nga kuptimi dhe përdorimi është pjesëza tjetër ekspresive-emocionale *ç*, me origjinë përemërore, p.sh.

«Na ngordhi kali, i ranë thojt, ç'po vrapon Balli t'i heq patkojn» (Sh. Mu. «Epopeja...», f. 14). /«Ç'u tha portokallja, / ç'u tha zerdelija, /ç'u tha trëndafili / dhe me to qershia» (F. Gj. «Kënga e partizanit Benko» A.L.Sh. f. 496).

Në thjeshtligjërime e në gjuhën bisedore për të përforcuar kënaqësinë e pakënaqësinë e folësit, zemërimin, revoltën, kundërshtimin e tij etj. përdoret dendur pjesëza ekspresive-emocionale *ë* (*hë*).

«Një qënkemi ti e unë *ë*? Si këmbët e dhisë *ë*? (M. Kut. «Xinxifilua», f.27). «— Po ti mistrec i mban anën *hë*? U bëre dhe ti të japësh mëndje? (N. Pr. «Çezma... f. 81).

Pjesëza *aspo* përdoret shumë rrallë. Jep zakonisht nuancën e përçmimit ndaj sendit, frymorit a fenomenit të emërtuar nga fjala së cilës i referohet kjo pjesëzë. P.sh.

«U pika në kokë/ Ëndër *aspo*!» (K.G.Sh.)

De është një pjesëz që haset dendur në thjeshtligjërime dhe në gjuhën bisedore. Është e pasur me nuancat kuptimore që merr gjatë përdorimit të saj në fjali. P.sh.

«Përgjigjmu *de*, pse më shikon me bisht të syrit» (K.G.Sh.) «*E de* nuk kupton» (R. Brah. «Tregime» f. 177). /S'do t'i linja të vdisnin *de*!» (K.G.Sh.)

Me vlerën e një pjesëze emocionale-ekspresive në gjuhën bisedore e sidomos në thjeshtligjërime përdoret bashkimi i qendrueshëm *pa le*, i formuar nga pjesëzat *pa* dhe *le*. Përdorimi i këtij bashkimi të qendrueshëm i jep kuptimit të përgjithshëm të fjalisë nuanca nga më të ndryshmet si lejim, zbutje, dëshirë, mosbesim, ironi, tallje, mburrje, përçmim etj., nënvizon në mënyrë të dukshme emocionin e folësit, gjallëron shumë të folurit.

«Të kisha një nuse për djalin si Myneveri, *pa le* të mos kisha një krah» (B. My. «Fluturzat...», f. 56). /«Edhe roje *pa le*. Ç'të duhet roja ty bre Bim?» (Sh. Mu. «Para...», f 250). «*Pa le* pastaj kur të mbarojë ndonjë shkollë jashtë» (K.G.SH.).

Ndonjëherë *pa le*, përdoret jo vetëm për të nënvizuar emocionin por edhe për të treguar se ajo që thuhet në fjalinë së cilës i përket, konsi-

32) Elementët përbërës të kësaj pjesëze të përngjitur (ish lidhëza *se* dhe ish përemri pyetës *ç*) duhet të shkruhen së bashku për t'i dalluar nga përdorimi i tyre i lirë në fjalitë kundrinore të pyetjes së zhdrejtë. Shih dhe «Rregullat e drejtshkrimit të shqipes (projekt)» f. 71).

derohet si diçka e tepërt, jashtë çdo mundësie vërtetimi; afrohet kë-shtu për nga kuptimi me *le që*.

«Ka disa intelektualë qytetesh që u vjen shumë zor të largohen nga qytetet kryesore dhe, kur dërgohen të punojnë në ndonjë qytet të vogël, i varin buzët, *pa le* kur dërgohen në fshat, që nuk u pëlqen fare... as që lidhen... siç duhet me punën. me fshatin, *pa le* të mendojnë pastaj të marrohen me vajza fshati» (E. Hoxha «Letër mësueses Athina Mile»).

2. Pjesëzat ekspresive *e dhe, edhe, pra, e pra, se, që, sikur* e rrallë herë e ndonjë tjetër, kanë dalë nga shndërrimi funksional i lidhëzave korespondonjëse. Në kontekste e kushte të caktuara ligjërimit lidhëzat *e, dhe, edhe, pra, e pra, se, që, sikur* etj. humbasin funksionin e tyre të mëparshëm dhe nuk shërbejnë më për të lidhur dy gjymtyrë a dy fjali, por për elokuencë, për të gjallëruar e zbukuruar tregimin, për të rritur fuqinë shprehëse të ligjërimit, përdoren pra si pjesëza ekspresive. Secila nga këto pjesëza ruan mjaft të gjallë kuptimin e mëparshëm, gjë që flet për afërinë e lidhjen e ngushtë të secilës nga këto pjesëza me lidhëzën korespondonjëse. Kështu pjesëzat *e, dhe, edhe* e kanë akoma kuptimin shtesor (shtues), pjesëza *pra, e pra* përmbajnë edhe idenë e përmbylljes, *se* dhe *që* japin idenë e shkakut ndërsa *sikur* sjell nuancat e kushtit dhe supozimit. Në raste të tilla, *pra*, nuk kemi të bëjmë me pjesëza të mirëfillta por me lidhëza të përdorura si pjesëza.

Pjesëzat ekspresive *e, dhe, edhe, pra, e pra* përdoren më shumë në gjuhën e shkruar. Pjesëza *pra* përdoret sidomos në stilin libror. Pjesëzat ekspresive *se, që, sikur* përdoren kryesisht në gjuhën bisedore e në thjeshtligjërimit.

«Nastasi, moj Nastasi! — ... a s'na sill moj bijë, atë plloskën e madhe të verës! *Dhe* plloska e madhe sa një bucelë shkoi dorë më dorë e gojë më gojë». (S. And. «Tregime...», f. 38). /«*Dhe* anija çan përpara» (Titulli i një tregimi të N. Turhanit në «10 Korriku» nr. 9 1968) / «Po të vendosim një enë me ujë mbi hekurin e nxehtë të një stufe, temperatura e enës dhe e ujit do të ngrihen, kështu *pra*, nxehtësia përhapet dhe nga një trup në një tjetër». («Fizika» e klasës VIII, Botim i Ministrisë së Arësimit dhe kulturës, Tiranë, 1968, f. 14). /Vata: Më vrau Marashi / Tuçi: Sot të vrau me fjalë, po prit kur të të vrasë me plumb./ Vata: *E pra*, Filen nuk do ta gëzojë kush posë meje» (K. Jakova «Toka jonë». A.L.S.H. f. 437). /«*se* ku ta dini ju more, *se* ky Ollman Beu ish njeri i qefit dhe i ahengut!» (M. Kut. «Netë...», f. 85). /«*Se* ç'ish e saja, gjyshja e kish këtë të vinte në gjumë, kur desh, me një të parë e një të hapur gojë» (M. Kuteli «Netë...», f. 65) / «*Që* thoni ju, në këto anët tona gjithënjë kështu ka qënë.» (Z.p. 23.2.1968) / «*E që* ta dini ju, ky kajmekam Hajdar Efendiu është përpjekur me mish e me shpirt të shtrojë malet e fushat ndënë këmbën e Dovletit e të bejlerëve» (M. Kut. «Netë...», f. 92) /«*Oh, sikur* të kisha një maqinë të punonte për mua!» (Host. nr. 3. 1969). /*Sikur* e shoh edhe sot xha Brahon tonë atje ndënë hijën e pjergullave» (M. Kut. «Netë...», f. 117).

3. — Pjesëzat thirrmore ose eksklamative

Këtë nëngrup të pjesëzave emocionale ekspresive e formojnë disa përemra e ndajfolje pyetëse, që përdoren në fjali thirrmore a eksplamative si mjet karakteristik strukturor, që dallohen në të folur nga intonacioni i veçantë, që humbasin kuptimin e tyre leksikor të pavarur e

që për rrjedhim nuk mund të jenë gjymtyrë në vete të fjalisë. Në këtë mënyrë këto ndajfolje dhe përemra shndërrohen në pjesëza thirrmore e shërbejnë për të theksuar anën emocionale të fjalive ku bëjnë pjesë, përforcojnë habinë, admirimin, entuziazmin, kënaqësinë dhimbjen, zemërimin, frikën, ironinë, përbuzjen, thirrjen, hutimin etj. Ndër përemrat dhe ndajfoljet që kalojnë në radhën e pjesëzave thirrmore dallohen ç, sa, si, qysh, ku, kur, pse. Shëmbujt:

«Të kthehej?! Ç'fjalë ish kjo! Ajo s'ish vetëm Ollgë, ajo kish dhe emrin partizane» (Sp. pop. 16.1.1968). /«Ç'e sëmure doktor! Ajo dje na magjepsi me atë zë si të bilibilit...» (Nend. nr. 3, 1968, f. 3). /«Sa të drejta janë këto fjalë të udhëheqësit tonë!» (Z.p. 4.2.1968). /«Si nuk t'u përkëmb vallë shtati.? Si nuk u tha motra jote e thaftë vera? Po qysh të duroj unë..? (M. Kut. «Tregime» f. 40). /«E mira s'ka fund thanë ata. Si s'paska fund? Ç'doni tjetër?» (Host. nr. 3.1968). /«U rrëzova shoku nënoficer i rojës. Qysh ore të rrëzoi?! Po ti u pregatite» (10 Ko. nr. 12, 1968). /«Bën kjo të ngrihet vetë, po ku je ti! S'tundet dot nga vendi» (M. Kut. «Xinxifilua», f. 5). /«Ku ka gojë Xhezua, more! — Kishte dhe brisk fare, bile...» (T. Laço «Njerëz...», Drita, 6.10.1968). /«Ku misri në arat e tjera, ku në arën e Demirit». (A. Ab. «Tri...», f. 31). /«Pse puna ime është ajo?» (N.Pr. «Çezma...», f. 104). /«Pse s'të njoh unë?!» (F.Gj. «Tana», f. 6).

Duke mbyllur vërejtjet tona për pjesëzat, duke u bazuar në ato që u thanë për to në këtë punim, do të deshim të jepnim ndonjë mendim lidhur me paraqitjen e pjesëzave në «Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe».

1. — Ç'është pjesëz, në «Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe» do të jepet si fjalë më vete, e shoqëruar me shënimin gramatikor përkatës. Pjesëzat «nuk do të kenë një shënim të tillë në qoftë se ky jepet brenda në shpjegim dhe ato kanë një kuptim»³³. P.sh. nuk. Pjesëz mohuese: ne, komunistët nuk i fshehim pikëpamjet tona politike. «Kur... pjesëzat kanë më se një kuptim atëhere shënimi i pjesës së ligjëratis është i domosdoshëm dhe vihet menjëherë pas fjalës titull, përpara se të fillojë shpjegimi i kuptimeve»³⁴. P.sh. Ja. Pjesëz I. Përdoret... 2... 3... etj.

2. — Në fjalor duhet të jepen gjithashtu bashkimet e bashkëlidhjet e qendrueshme të fjalëve me vlerën e një pjesëze si ja pse, kur ja, pa le, posi jo, se mos etj. (Kështu duhen konsideruar edhe ato bashkime që formohen nga përsëritja e së njëjtës pjesëz, zakonisht duke marrë ndonjë fjalëz tjetër në mes. P.sh. po e po, por mor po, jo që jo, jo se jo, vetëm e vetëm, gati-gati, bile-bile etj.). Këto bashkime të qendrueshme do të vendosen pas shenjës konvencionale ◆ në pjesën e dytë të artikullit të asaj pjesëze, me të cilën lidhen ngushtë, janë të afërta apo të njëlljohta për nga kuptimi. P.sh. Bashkimet e qendrueshme ja pse, kur ja do të jepen tek pjesëza ja, pa le tek pjesëza emocionale ekspresive pa; posi jo tek pjesëza pohuese posi: se mos tek pjesëza pohuese posi: se mos tek pjesëza e dyshimit mos etj.

3. Sigurisht për kohën në të cilën janë hartuar fjalorët e mëparshëm kërkesa për të zgjidhur problemin e karakteristikës stilistikore të fjalëve, pra edhe të pjesëzave, përbënte vështirësi të mëdha objektive, prandaj edhe shënimet stilistikore për pjesëzat në këta fjalorë mungojnë. Problemi i karakteristikës stilistikore të fjalëve, për arësye tashmë të njohura, vazhdon të jetë i vështirë. Megjithatë, si të gjitha fjalët edhe

^{33, 34} A. Kostallari, *Parimet themelore për hartimin e «Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe»*, «Studime filologjike» nr. 2, 1968, f. 121.

pjesëzat në fjalor duhet të shoqërohen me shënimet *bised., thjeshtligj., libr., vjet., krahin., etj.*

Kështu nuk mund të vendosen në një plan pjesëza *ja* me pjesëzat *namëta, na, qe, nji;* pjesëzat *ama, seç, ç, pa le, sos, de, se, pa* (emocionale ekspresive) *aspo, se mos* (të gjuhës bisedore dhe të thjesht ligjërimin), me pjesëzat *veçanërisht, pikërisht, rreth, madje* (të gjuhës së shkruar, të stilit libror), ose me pjesëzat *s, nuk, mos, po, jo, vallë* etj. (si të gjuhës bisedore dhe të gjuhës së shkruar).

4. Ashtu sikurse dallimi i polisemisë nga homonimia në përgjithësi, edhe dallimi i kuptimeve të ndryshme të së njëjtës pjesëze nga pjesëzat homonime është me rëndësi për praktikën leksikografike. Sigurisht që edhe në «Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe» paraqitja e pjesëzave dhe e pjesëve të ligjëratës që dalin homonime do të përbëjë vështirësi. Dihet parimi i përgjithshëm që homonimet, rrjedhimisht edhe pjesëzat homonime do të jepen si fjalë të veçanta. Kështu p.sh. pjesëzat *pa* (zbutëse) dhe *pa* (emocionale-ekspresive), *po* (aspektive), *po* (pohuese), *po* (emocionale-ekspresive) etj. do të paraqiten si fjalë në vete sepse përbëjnë homonime. Por sidoqoftë, në zgjidhjen e drejtë të këtij problemi do të ndihmonte shumë një studim i posaçëm për homoniminë në pjesët e pandryshueshme të ligjëratës.

5. Së fundi, pjesëzat ekspresive (*e, dhe, edhe, pra, e pra, se, sikur*) si dhe pjesëzat eksklamative a thirrmore (*c, sa, si, qysh, ku, pse* etj.) të pa pasqyruara deri tani në fjalorët e shqipes, duhet të jepen në fjalor. Këto pjesëza «të rastit», jo të mirëfillta, të formuara nga shndërrimi funksional i lidhëzave, nga shqiptimi me intonacion të veçantë i ndajfoljeve dhe të përemrave të pakufishëm e pyetës, mendojmë se duhet të vendosen në artikujt e lidhëzave, ndajfoljeve, përemrave përkatës mbas të gjitha kuptimeve e përdorimeve të tjera, të ndara me shifra arabe dhe të shoqëruara me ndonjë shënim të veçantë si: *përdoret si pjesëz, përdoret si fjalë eksklamative a me ndonjë shënim tjetër.*

* * *

Në këtë punim u përpoqëm të përcaktonim pjesëzat si një grup i veçantë i fjalëve shërbyese dhe të bënim një klasifikim të tyre sipas kuptimit. Përkufizimin e dhënë nga Sh. Demiraj e zgjeruam, duke theksuar sidomos rolin e pjesëzave të shqipes për shprehjen e modalitetit, të emocionit dhe të ekspresivitetit, për rrjedhim në klasifikimin tonë kemi shtuar disa grupe pjesëzash, që më parë nuk kanë qenë dalluar.

Duke shqyrtuar veçoritë e pjesëzave, duke parë vendin që zënë ato midis fjalëve të tjera shërbyese, duke i krahasuar me fjalët modale dhe me ndajfoljet, del e qartë që pjesëzat përbëjnë një kategori leksiko-gramatikore më vete, zënë një vend të veçantë midis të gjithë pjesëve të tjera të ligjëratës.

Tek pjesëzat, sidomos tek pjesëzat emocionale-ekspresive dallohet mirë funksioni ekspresiv, i cili është karakteristik për fjalën. Prania e këtij funksioni tek pjesëzat tregon pra dhe një herë që ato janë njësi leksikore të gjuhës.

Duke bërë klasifikimin e pjesëzave, duket edhe më mirë mungesa e kuptimit leksikor të mvetësishëm të pjesëzat. Shqyrtimi dhe studimi i një materiali të gjerë vërteton se të marra të shkëputura, të izoluara, jashtë tipit të caktuar të konstruktit, jashtë kontekstit vështirë se mund

të gjesh nuancat kuptimore të tyre, zor se mund të përcaktosh vendin e pjesëzës në këtë klasifikim. Në kontekste të ndryshme pjesëza shfaq nuanca të ndryshme kuptimore, e atëhere vendin e pjesëzës në klasifikim e përcakton përdorimi më i zakonshëm.

Nga vështrimi që u bëmë disa fjalorëve të shqipes del se pjesëzat janë pasqyruar gjithnjë e më shumë nga një fjalor në tjetrin, gjë që lidhet me rritjen e vazhdueshme të radhës së pjesëzave në gjuhën shqipe nga njëra anë dhe me dallimin gjithnjë më të madh të pjesëzave si grup leksiko-gramatikor më vete në gramatikat e huaja e sidomos në gramatikat tona nga ana tjetër.

Sigurisht mjaft probleme nuk janë shtruar dhe nuk mund të shtroheshin e aq më tepër nuk mund të zgjidheshin në një punim të vetëm, me detyra e qëllime të kufizuara. Në këtë punim janë prekur çështje të tilla si dallimi dhe afëria e pjesëzave modale me fjalët modale, e pjesëzave me ndajfolje dhe me fjalët shërbyese, e pjesëzave fjalëformuese me parashtesat dhe prapashtesat. Të gjitha këto çështje janë me interes dhe me rëndësi për praktikën leksikografike, për praktikën shkollore e mund të bëhen objekt punimesh të veçanta. Me shumë rëndësi është problemi i karakterizimit stilistikor të pjesëzave si dhe i polisemisë dhe homonimisë në pjesëzat dhe në të gjitha fjalët shërbyese, sidomos tani kur numri i pjesëzave dhe përdorimi i tyre (p.sh. përdorimi i pjesëzave emocionale-ekspresive, i pjesëzave modale etj. në gjuhën e folur) në shqipe është rritur shumë.

Grumbullimi gjithnjë më i madh i një materiali për pjesëzat në shqipen e sotme, përpunimi i mëtejshëm i kriterëve shkencore do të çojë më përpara studimin për pjesëzat.

SHKURTIMET

- | | |
|-----------------------|--|
| A. Ab. «Tri...» | A. Abdihojha, «Tri ngjyra të kohës», Tiranë 1965 |
| B. My. «Fluturzat...» | B. Myftari, «Fluturzat e borës», Tiranë 1967 |
| «Drita» | Gazeta «Drita» |
| «10 Ko.» | Revista «10 Korriku» |
| «A.L.SH.» | Antologji e letërsisë shqipe për shkollat e mesme, Tiranë 1964 |
| Dh. Sh. «Kënga...» | Dh. Shuteriqi, «Kënga dhe pushka», Tiranë 1963 |
| «Çlir...» | «Çlirimtarët» II, Tiranë 1955 |
| F. Gj. «Përmbysja» | F. Gjata, «Përmbysja», Tiranë 1954 |
| «Tana» | «Tana», Tiranë 1958 |
| F. Pa. «Mbi...» | F. Paçrami, «Dy drama (Mbi gërmadha)», Tiranë 1963 |
| «Host.» | Revista «Hosteni» |
| J. X. «Lumi...» | J. Xoxa, «Lumi i vdekur», Tiranë 1965 |
| «Novela» | «Novela», Tiranë 1958 |

- K.G.SH. Kartoteka e gramatikës së shqipes
- Mao Ce Dun «Citate» Mao Ce Dun, «Citate», Tiranë 1968
- M. Shehu «Lufta...» M. Shehu, «Lufta për çlirimin e Tiranës»,
Tiranë, 1945
- «Kujtime...» «Kujtime nga jeta e Brigadës I-rë
sulmuese», Tiranë 1945.
- Migjeni «Luli i vocër» Migjeni, «Luli i vocër», Tiranë 1966
- M. Kut. «Xinxifilua» M. Kuteli, «Xinxifilua», Tiranë 1962
- «Tregime...» «Tregime të moçme shqiptare»,
Tiranë, 1965
- «Netë...» «Netë shqiptare», Tiranë 1944
- «Nend» Revista «Nëndori».
- N. Pr. «Lëkura...» N. Prifti, «Lëkura e ujkut», Tiranë 1958
- «Çezma...» «Çezma e floririt», Tiranë 1960
- «Pion.» Gazeta «Pionieri»
- «Përpara» Gazeta «Përpara», Korçë
- P. Marko «Qyteti...» P. Marko, «Qyteti i fundit», Tiranë 1960
- R. Brah. «Tregime», R. Brahimi, «Tregime», Tiranë 1959
- R. Nep. «Fusha...» R. Nepravishta, «Fusha po zgjohet», Tiranë
1955
- Sp. pop Gazeta «Sporti popullor»
- S. And. «Tregime...» S. Andoni, «Tregime nga Morava», Tiranë
1960
- «Lufta...» «Lufta partizane», Tiranë 1959
- «Kandili...» «Kandili i shuar», Tiranë 1964
- S. Ko. «Një tufë...» S. Kolea, «Një tufë proverbash», Tiranë 1944
- S. Sp. «Ata...» S. Spasse, «Ata nuk ishin vetëm», Tiranë 1952
- «Afërdita...» «Afërdita përsëri në fshat»,
Tiranë 1956
- Sh. Mu. «Para...» Sh. Musaraj, «Para agimit», Tiranë 1965
- «Epopeja...» «Epopeja e Ballit Kombëtar»,
Tiranë 1948
- V. Vi. «Lumturia» V. Vinçani, «Lumturia», Tiranë 1965
- Z. p. Gazeta «Zëri i popullit»
- Z. r. Gazeta «Zëri i rinisë»

R é s u m é

LES PARTICULES COMME CATEGORIE LEXICO-SEMANTIQUE
EN ALBANAIS D'AUJOURD'HUI

1. Dans le travail ci-contre en albanais, dont nous faisons le résumé, est faite la définition des particules, comme groupe particulier des mots accessoires et l'on en a fait aussi une classification. Quoique les particules, comme mots, soient en petit nombre, et même dénombrables, leur division des autres termes de rapport et des adverbess et termes modaux n'est pas aisée.

Avec les autres mots accessoires, les particules ont en commun l'absence d'acception lexicale proprement dite, l'absence de la fonction nominative, l'inaptitude à être des membres à part de la proposition. Elles diffèrent de celles-ci du fait que, tandis que les particules servent à apporter des nuances d'acception des plus variées dans la proposition, tous les autres mots accessoires sont usités en vue de mettre au jour les rapports entre les membres de la phrase et les propositions.

2. De leur affinité aux adverbess parlent, entre autres, le passage de plusieurs adverbess en particules, en raison de l'affaiblissement sémantique, la parution du même mot tantôt comme adverbe et tantôt comme particule — d'après le contexte — les liens syntaxiques et les conditions du discours.

Mais les adverbess varient des particules du fait que, tandis que les premiers rentrent dans le type des mots indépendants et marquants, les secondes font partie des mots accessoires.

3. Les particules modales ont beaucoup d'affinité avec les mots modaux. C'est la même destination qui les unit. Les deux parties servent à exprimer la modalité. Mais les mots modaux, à différence des particules modales, ont un sens lexical plus ou moins indépendant, ils peuvent emprunter le rôle des mots intermédiaires dans la proposition, n'entrent pas dans une seule partie de la phrase et enfin se réfèrent à tout le discours. Si l'on voulait comparer les adverbess, les particules et les mots accessoires d'après le degré d'indépendance de l'acception lexicale, on aurait le rangement suivant: adverbess, mots modaux, particules.

Toutes ces particularités des particules rendent possible d'aboutir à la conclusion que les particules doivent être considérées comme une partie à part du discours, comme une catégorie lexico-grammaticale particulière.

4. La détermination de cette catégorie de mots n'est pas aisée. A été élargie et faite avancer la classification pour les particules par Sh. Demiraj.

Toutes les particules ont été divisées en quatre grands groupes:

I. Particules qui extériorisent des nuances générales de sens non modal, que l'auteur divise en six autres groupes (indicatives, déterminantes, disjonctivo-limitatives, d'affinité, aspectives, affirmatives).

II. Particules modales et modalo-volitives (antérieurement non parfaitement définies et sans un nom particulier comme groupe) que l'auteur divise en quatre autres sous-groupes (affirmatives, négatives, dubitatives, d'adoucissement).

III. Particules *émotivo-expressives* (ce groupe des particules de l'albanais est distingué pour la première fois dans ce travail). Ce groupe est divisé en trois sous-groupes (*émotivo-expressives, expressives, exclamatives*).

IV. Particules de formation de forme ou de formation de mots. Des particules de formation de forme ce travail ne s'occupe point. Des particules de formation de mots l'auteur s'est occupé de passage. Il fait ressortir les différences qui existent entre les particules et les affixes de formation des mots.

Les classifications antérieures distinguaient les genres suivants de particules: *indicatives, déterminatives, disjonctivo-limitatives, affirmatives, négatives, dubitatives, d'adoucissement*.

5. L'auteur a brossé dans son travail également quelques-unes des voies de la formation des particules et il fait également une classification de celles-ci en lignes générales d'après l'origine.

L'auteur insiste sur le besoin de l'étude des particules à plusieurs égards, et notamment en connexion avec leur formation. Cette question est d'importance, surtout si l'on tient présent que la classe des particules va croissant en albanais.

6. Enfin, l'auteur considère nécessaire que de ce travail soient données aussi quelques conclusions concernant la reproduction des particules dans le dictionnaire en préparation de l'albanais une question très importante celle-ci surtout si l'on tient présent que les particules dans les dictionnaires antérieurs de l'albanais, en dépendance du traitement théorique qu'on leur a fait, ne sont insérées presque point ou elles ne le sont que très peu.

